



Republika e Kosovës



Komuna e Prishtinës

# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT LOKAL EKONOMIK PËR KOMUNËN E PRISHTINËS 2013 - 2016



GUSHT 2013, PRISHTINË





Republika e Kosovës



Komuna e Prishtinës

# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT LOKAL EKONOMIK PËR KOMUNËN E PRISHTINËS 2013 - 2016

*Prishtina kryeqytet i Kosovës, qytet metropolitan me tipare evropiane, e njohur për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime publike efikase e cilësore, e integruar në zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale e financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.*

**TË DHËNAT  
BAZË  
PËR PRISHTINËN**

<p><b>POPULLËSIA</b></p>	<p>Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, Prishtina ka 198.897 banorë (49.8% meshkuj dhe 50,2% femra), 40.292 ekonomi familjare dhe 58.849 njësi të banimit. <i>Vlerësimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të pasluftës si dhe vlerësimet që dalin nga shërbimet që u ofrohen qytetarëve flasin se në Prishtinë jetojnë rreth 450.000 deri në 500.000 banorë.</i></p>
<p><b>SIPËRFAQJA DHE VENDBANIMET</b></p>	<p>Sipërfaqja e komunës është rreth 523 km<sup>2</sup> (end në diskutim) prej të cilave 60 km<sup>2</sup> i takojnë zonës urbane të Komunës</p>
<p><b>BIZNESI</b></p>	<p>Qendër e koncentrimit të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare. Rreth 10,000 biznese private kryesisht operojnë në tregti (35.02%), shërbime profesionale (15.49%), hotelet dhe restorante (10.02%), prodhim (7.73%), transport (5.81%), kujdesi shëndetsor (2.45%), arsimit (1.45) patundshmëritë dhe qiradhënia (1.98%), dhe 20.05% janë kryesisht shërbime dhe veprimatri tjera)</p>
<p><b>TRANSPORTI</b></p>	<p>Prishtina është qendra më e madhe ekonomike, administrative, arsimore dhe kulturore në Kosovë. Nodohet 16 km larg Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe 6 km larg hekurudhës për transport ndërkombëtar të mallrave. Pothuajse të gjitha rrugët kryesore kalojnë nëpër Komunën e Prishtinës, përfshirë edhe autostradën "Ibrahim Rugova" që është në ndërtim e sipër.</p>
<p><b>KLIMA DHE NIVELI MBIDETAR</b></p>	<p>Prishtina është e vendosur në koordinatat 42°40'0" Veri dhe 21°10'0" Lindje. Niveli mbidetar sillet 535-580 metra, me klimë kontinentale, me dimra të ftohte dhe verëra të nxehta, me mesatare të reshjeve prej 600 mm për vit.</p>
<p><b>KUFIZIMI GJEOGRAFIK</b></p>	<p>Podujeva në veri, Kastrioti në perëndim, Fushë Kosova në jug-perëndim, Graçanica dhe Lipjani në jug, Novobërda në jug-lindje dhe Kamenica në perëndim. Në pjesën veri-lindore kufizohet me Republikën e Serbisë.</p>

# PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës .....	6
1. Hyrje .....	8
2. Përmbledhje ekzekutive .....	9
3. Korniza institucionale dhe qeverisja demokratike .....	11
4. Ekonomia .....	12
4.1. Buxheti: burimet e të hyrave dhe shfrytëzimi i tyre .....	12
4.2. Bizneset dhe rrethina e biznesit .....	15
4.3. Zhvillimi rural .....	16
5. Organizimi i shërbimeve publike .....	20
6. Zhvillimi dhe qëndrueshmëria urbane .....	24
7. Infrastruktura lokale .....	27
8. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti .....	28
9. Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale .....	32
11. Vizioni .....	37
12. Synimet dhe objektivat .....	37
13. Projektet për arritjen e synimeve dhe objektivave .....	41
14. Shtojca I: Ekipi i strategjisë .....	60

# SHKURTESAT

<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>b.</b>	Banorë
<b>DUNMM</b>	Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit, dhe Mbrojtjes së Mjedisit
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale për Arsim
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>ha</b>	Hektar
<b>IZHNJ</b>	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
<b>KEK</b>	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
<b>KK</b>	Kuvendi i Komunës
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>PZHU</b>	Plani i Zhvillimit Urban të Prishtinës
<b>PUN</b>	Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari
<b>PPP</b>	Partneritet Publiko-Privat
<b>QKMF</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
<b>QMF</b>	Qendra e Mjekësisë Familjare
<b>UNDP</b>	United Nations Development Program

**FJALA HYRËSE  
E KRYETARIT  
TË KOMUNËS**



Të dashur prishtinas,

Ne kemi filluar një jetë të re në Kosovën e re. Pas datës 17 shkurt 2008, kemi hyrë në fazën e realizimit të synimeve tona për një Kosovë të zhvilluar dhe të qëndrueshme ekonomikisht dhe politikisht. Prishtina me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është përcaktuar Kryeqytet i Republikës së Kosovës.

Me këtë dokument strategjik ne po sigurojmë mekanizma që ta bëjmë realitet vizionin tonë për ***Prishtinën kryeqytet i Kosovës, qytet metropolitan me tipare europiane, e njohur për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime efikase e cilësore, e integruar në zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale e financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.***

Me këtë strategji zhvillimore, e cila mbulon periudhën kohore 2013-2016, ne fuqizojmë përfshirjen e komunitetit dhe të palëve të tjera me interes për të arritur progresin dhe kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës së Prishtinës përmes shfrytëzimit më të mirë dhe të balancuar të ambientit dhe të të gjitha resurseve të tjera.

Objektivat tona në këtë strategji orientohen në realizimin e qëllimeve esenciale në interes zhvillimor të qytetarëve. Duke ditur rolin e Kryeqytetit, ne po ashtu kemi për qëllim që të ofrojmë shërbime edhe për qytetarët e tjerë të Kosovës dhe të banorëve jo të përherëshëm të Prishtinës, si dhe të prezencës ndërkombëtare, e cila së bashku me komunitetin lokal, po luan rol të rëndësishëm në jetën publike, kulturore dhe ekonomike në Kryeqytetin tonë.

Ky dokument strategjik i zhvillimit të Komunës së Prishtinës është balancues dhe ndërton baza të mira për zhvillim të qëndrueshëm. Përveç objektivit parësor, që është zhvillimi ekonomik i Prishtinës, ka arritur që të ndërtojë baraspeshën zhvillimore në aspektin hapësinor, të zhvillimit social, arsimin, kulturën, infrastrukturën fizike dhe zhvillimit rural.

Të nderuar prishtinas, unë, në cilësinë e Kryetarit të Komunës, ju ftoj që së bashku ta jetësojmë këtë dokument si bazë strategjike zhvillimore, duke përcaktuar kështu cilësinë e jetës sonë dhe të brezave që vijnë dhe qëndrueshmërinë tonë zhvillimore.

I juaji Kryetari,

**Prof. dr. Isa Mustafa**

## 1. HYRJE

Në këtë dokument strategjik Komuna e Prishtinës ofron vizonin, përcakton synimet, objektivat strategjike dhe mekanizmat për ta zhvilluar Prishtinën drejt një kryeqyteti me tipare evropiane dhe metropolitane. Ky dokument është hartuar nga një ekip profesional dhe në debat të ngushtë me Kryetarin e komunës, anëtarët e Kuvendit Komunal, stafin komunal, ekipit të ekspertëve, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit. Prandaj, si i tillë përbën një obligim të përbashkët për të zhvilluar Prishtinën si kryeqytet me tipare metropolitane.

Prishtina është qendër administrative dhe kulturore e vendit, është qyteti ku janë të koncentruara numri më i madh aktiviteteve ekonomike në nivel vendi. Pas luftës Prishtina është ballafaquar me një rritje të shpejtë të numrit të banorëve, duke shumëfishuar kështu problemet sociale, të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Si rezultat i lëvizjeve demografike, sot, konsiderohet se numri i shfrytëzuesve të shërbimeve të Prishtinës është pothuajse dyfish më i madh se numri i banorëve të Prishtinës. Periudha e pasluftës ka qenë një periudhë e definimit të zhvillimit institucional dhe ekonomik të Prishtinës. Ky rregullim institucional nuk mund të konsiderohet i kompletuar dhe funksional pa miratimin e Ligjit për Prishtinën i cili do të hapte shumë mundësi zhvillimore.

Me gjithë këto sfida, kjo strategji paraqet një hap të rëndësishëm drejt realizimit të vizionit për Prishtinën. Strategjia ofron zgjidhje praktike për shumë probleme aktuale dhe përmirëson pozicionin konkurrues të Prishtinës në raport me komunat dhe qytetet e mëdha të rajonit. Konform këtij pozicioni konkurrues dhe kufizimeve buxhetore janë përcaktuar synimet dhe objektivat për periudhën 2013-2016.

Procesi i hartimit të strategjisë ka qenë një proces gjithëpërfshirës me përfaqësues të të gjitha palëve të interesit, me vëmendje specifike në komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, grupet sociale etj. Të gjitha aktivitetet për përgatitjen e kësaj strategjie janë koordinuar nga "Këshilli Drejtues i Strategjisë", ku kanë marrë pjesë udhëheqësit më të lartë të komunës dhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e Kuvendit Komunal, përfaqësuesit e biznesit dhe të shoqërisë civile. Gjatë procesit të hartimit të strategjisë janë themeluar 5 grupe punuese me përfaqësues nga drejtoritë komunale dhe nga komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile. Instituti IESB-D&D në këtë proces ka mbështetur grupet punuese përmes ofrimit të ekspertizës së tij në hartimin e strategjisë dhe çështjeve të zhvillimit lokal. Instituti IESB-D&D ka angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe ka organizuar 2 punëtori dhe dhjetëra takime pune. Grupet kanë zhvilluar takime të shpeshta dhe konsultime me grupet e interesit. Janë organizuar dy punëtori dhe një vizitë studiuuese në të cilat stafi komunal është trajnuar lidhur me hartimin e strategjisë dhe menaxhimin e projekteve. Gjatë këtyre punëtorive është bërë agregimi i rezultateve të grupeve individuale dhe janë diskutuar në grupe më të gjëra si tërësi. Pas përpilimit të draftit të parë është zhvilluar një konsultim intensiv me grupet e interesit dhe janë marrë në konsideratë sugjerimet e tyre.

Ky dokument është organizuar në këtë mënyrë. Kapitull 2 jep një pasqyrë përmbledhëse të përshkrimit të gjendjes, vizionit dhe synimeve të strategjisë

zhvillimore. Në kapitullin e tretë jepet një pasqyrë e kornizës institucionale dhe qeverisjes lokale. Në kapitullin 4 pasqyrohet gjendja në ekonominë dhe zhvillimin rural. Në kapitullin 5 paraqitet niveli i shërbimeve publike që ofrohen nga komuna. Në kapitullin 6 paraqitet zhvillimi urban. Në kapitullin 7 paraqitet infrastruktura lokale dhe në Kapitullin 8 arsimi, kultura, rinia dhe sporti. Në kapitullin 9 jepet një vështrim i shëndetit publik dhe mirëqenies sociale. Në kapitullin 10 paraqitet analiza e pozicionit konkurrues SWOT. Kapitulli 11 ofron vizonin për Komunën e Prishtinës, ndërsa Kapitulli 12 përcakton synimet dhe objektivat. Në fund të dokumentit jepet lista e projekteve dhe ndërlidhja e tyre me objektivat dhe synimet e strategjisë si dhe kostoja financiare e tyre.

## 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Prishtina përveç se është qendër administrative dhe kulturore e vendit, është qyteti ku janë të koncentruara numri më i madh aktiviteteve ekonomike në nivel vendi. Si rezultat i zhvillimeve dinamike pas vitit 1999, Prishtina është ballafaquar me një rritje të shpejtë të numrit të banorëve, duke shumëfishuar kështu problemet sociale, të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Periudha e pasluftës ka qenë një periudhë e defnimit të zhvillimit institucional dhe ekonomik të Prishtinës. Me ndryshimin e sistemit elektoral në vitin 2007, Kryetari i Komunës zgjedhet me votat e qytetarëve dhe gjithashtu ka marrë kompetenca ekzekutive. Pas këtyre ndryshimeve institucionale, Komuna e Prishtinës ka ndryshuar numrin e drejtorive për t'iu përgjigjur më mirë situatës së krijuar. Megjithatë, Ligji për Prishtinën, i cili ende po ngecë të miratohet në Kuvendin e Kosovës, pritet të sigurojë një status të veçantë për Prishtinën si kryeqytet krahasuar me komunat e tjera në Kosovë.

Me një buxhet prej 63,193,317.44€ (sa ka qenë në vitin 2012) është shumë e vështirë të mbulohen nevojat e një kryeqyteti në rritje në të cilin numri i shfrytëzuesve të shërbimeve publike është pothuajse dyfish më i madh se sa ai i banorëve të Prishtinës. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prishtinës përbëhet nga granti qeveritar prej 63.3% ndërsa pjesa tjetër prej 36.7% nga të hyrat vetanake. Të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe nga tatimi në pronë, janë dy burimet kryesore të të hyrave vetanake. Me afro 10 mijë biznese aktive që operojnë në Komunën e Prishtinës, ekziston një potencial i madh i diversifikimit dhe rritjes së të hyrave komunale.

Problem në vete paraqet ofrimi i shërbimeve publike cilësore për numrin në rritje të popullatës. Komuna e Prishtinës ka intensifikuar punën lidhur me meremetime të rrugëve dhe ndërtim të rrugëve të reja, ndërtim dhe modernizim të rrjetit të kanalizimit, rritje të konsiderueshme të kapacitetit të furnizimit me ujë për qytetarët etj. Transporti publik mbetet një sfidë serioze për të ardhmen, ku në veçanti duhet të përmirësohet menaxhimi i kompanisë së transportit publik, të pajiset kompania me autobusë të rinj dhe të rritet efikasiteti i funksionimit si transport i integruar. Orientimet e Komunës së Prishtinës janë që të sigurohet transport publik integral, që merr në konsideratë të gjitha format e transportit publik për të rritur efikasitetin dhe mënjeluar ngarkesën e vetëm një forme të transportit publik. Për shumicën e lagjeve janë në zbatim planet rregulluese, por zbatimi i plotë i tyre mbetet një

sfidë për vitet e ardhshme, sidomos kur merren në konsideratë imigrimi i madh në qytet dhe rritja rapide e ndërtimeve për numrin në rritje të popullatës.

Megjithëse popullsia e Komunës së Prishtinës që jeton në zonat rurale është dukshëm më e vogël se në komunat e tjera, Prishtina ka shënuar një përparim të dukshëm në ngritjen e infrastrukturës për jetë cilësore dhe për zhvillim të aktiviteteve ekonomike bujqësore dhe jo-bujqësore në këto zona. Edhe pse viteve të fundit janë rritur kapacitetet për zhvillimin e shumë aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, ende ka hapësirë për rritjen e prodhimtarisë bujqësore dhe aktiviteteve të thera ekonomike të lidhur direkt ose indirekt me të.

Për të përballuar më me sukses sfidat për zhvillimin e komunës dhe për të krijuar një ambient më miqësor e më atraktiv për zhvillimin e biznesit dhe ngritjen e cilësisë së jetesës për banorët e saj, Komuna e Prishtinës ka përgatitur këtë dokument: *“Strategjia zhvillimore afatmesme e Prishtinës 2013-2016”*. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që, pas identifikimit të gjendjes, përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve për Komunën e Prishtinës, të propozojë vizionin dhe të identifikojë synimet, objektivat dhe projektet konkrete që do të promovojnë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të bëjë një hap të madh drejtë jetësisimit të vizionit të Prishtinës, kryeqytet metropol me tipare evropiane.

Pas shumë debateve, konsultimeve dhe analizave, Komuna e Prishtinës ka përvetësuar këtë vizion për zhvillimin e saj të qëndrueshëm dhe të balancuar ekonomik dhe shoqëror: ***Prishtina kryeqytet i Kosovës, qytet metropolitan me tipare evropiane, e njohur për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime publike efikase e cilësore, e integruar në zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale e financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.***

Bazuar në këtë vizion dhe në sfidat dhe mundësitë që ka Komuna e Prishtinës, ekipi i strategjisë ka identifikuar 9 synime, të cilat përmbajnë në vete 36 objektiva strategjike. Këto synime dhe objektiva kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e vizionit i cili ka një konsensus të gjerë. Synimet janë (renditja e synimeve nuk nënkupton prioritetin e tyre):

- *Synimi 1. Prishtina kryeqytet me tipare metropolitane dhe evropiane*
- *Synimi 2. Krijimi i një mjedisi më të favorshëm për zhvillim të bizneseve*
- *Synimi 3. Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe fizike për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve*
- *Synimi 4. Rritja më e shpejt e zhvillimit të qëndrueshëm rural*
- *Synimi 5. Zhvillimi i qëndrueshëm urban, hapsinor dhe mbrojtja e mjedisit*
- *Synimi 6: Përmirësimi i shërbimeve publike në përputhje me tiparet e një qyteti evropian*
- *Synimi 7. Ngritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve arsimore me infrastrukturë të mjaftueshme dhe funksionale, gjithpërfshirje, barazi dhe respektim të diversitetit në arsim*

- *Synimi 8. Rritja e cilësisë dhe numrit të ngjarjeve kulturore dhe sportive me infrastrukturë adekuate institucionale, teknike dhe profesionale*
- *Synimi 9. Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale*


Janë identifikuar mbi **230 projekte specifike**, që sigurojnë arritjen e synimeve dhe objektivave me një kosto totale prej **266.503.246€**. Megjithatë, kjo listë e projekteve nuk është përfundimtare, pasi që asaj mund t'i shtohen edhe projekte të tjera që mund të identifikohen në vazhdimësi. Për secilin projekt janë identifikuar partnerët e mundshëm implementues dhe afati i realizimit nga momenti i fillimit të projektit. Ekipi i strategjisë po ashtu ka identifikuar projekte që potencialisht mund të realizohen me koncesion, përmes partneritetit-publik privat apo huazimeve, kostoja e të cilave sillet rreth **42,700,000€** (kjo shumë nuk përfshihet brenda koston së përgjithshme të strategjisë). Investimet private në ndërtimtarë parashihet të jenë mbi **1,200,500,000.00 €**.


### **3. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE QEVERISJA DEMOKRATIKE**

Komuna e Prishtinës sipas të gjithë parametrave është komuna më e madhe në Republikën e Kosovës. Edhe pse Prishtina është kryeqytet i Republikës së Kosovës, ende nuk është nxjerrë Ligji mbi kryeqytetin që është edhe obligim kushtetues i legjislativit të vendit. Në mungesë të këtij ligji, Prishtina është mjaft e kufizuar në zhvillimin e saj si kryeqendër e shtetit dhe e krahasueshme me kryeqendrat e tjera të rajonit. Si pasojë e kësaj, edhe organizimi institucional i Komunës së Prishtinës nuk dallon shumë nga komunat tjera që janë shumë më të vogla. Megjithatë, Kuvendi i Komunës dhe organet udhëheqëse të komunës kanë bërë përpjekje që, brenda kornizës aktuale ligjore, të formojnë një strukturë mjaft funksionale qeverisëse dhe administrative në përputhje me nevojat e popullatës dhe bizneseve që jetojnë dhe veprojnë në territorin e saj.

Gjatë këtij mandati qeverisës, udhëheqja komunale i ka bërë disa përmirësime esenciale në strukturën organizative, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore dhe më të shpejta për qytetarët dhe bizneset. Së këndejmi, brenda drejtorateve janë formuar një numër i caktuar i sektorëve për fusha të caktuara, në mënyrë që të përmirësohet funksionalizimi dhe menaxhimi më i mirë i tyre. Struktura e re organizative (shih Figurën 3.1) është dëshmuar të jetë e qëlluar dhe si e tillë është pritur mirë nga marrësit e shërbimeve nga administrata komunale. Siç shihet dy shtyllat kryesore të qeverisjes janë legjislativi (Kuvendi i Komunës) dhe ekzekutivi (Kabineti i Kryetarit të Komunës). Ekzekutivi përbëhet nga drejtoritë dhe zyrat. Zyrat janë të ndërlidhura ngushtë me kabinetin e kryetarit të komunës por nuk janë pjesë e tij. Në anën tjetër drejtoritë janë të përbëra nga sektorët përkatës me qëllim të funksionimi më efikas. Funksionalizimi i kësaj strukture administrative është bërë i mundur edhe me shpërndarjen e administratës në pjesë të ndryshme të qytetit dhe në objektin e ri të Komunës në lagjen Arbëria, me çfarë janë krijuar kushte më të mira për ofrimin e shërbimeve për qytetarë dhe biznese.

Figura 3.1: Struktura organizative e Komunës (Organogrami)







Komuna e Prishtinës, veçanërisht qyteti i Prishtinës si kryeqytet i shtetit, ka pësuar rritje shumë dinamike të popullsisë në periudhën e pasluftës, kryesisht përmes migrimit të popullatës nga viset rurale të komunës, nga pjesët tjera urbane dhe rurale të Kosovës, si dhe nga shtetet fqinje. Po ashtu, Prishtinës i është rritur edhe rëndësia strategjike në fushën ekonomike-administrative. Gjatë tërë periudhës së pasluftës, strukturat qeverisëse janë përpjekur që Prishtinës t'i japin një fizionomi të një kryeqyteti metropolitan me tipare evropiane, duke arritur rezultate konkrete në zhvillimin institucional dhe ekonomik të komunës.

Në aspektin e organizimit administrativ dhe funksional, Komuna e Prishtinës ka 33 bashkësi lokale (sipas statutit të Komunës). Prej tyre, 20 e përbëjnë qytetin e Prishtinës dhe 13 iu takojnë zonave rurale. Me formimin e Komunës së Graçanicës, sipërfaqja e Komunës së Prishtinës është tkurrë përafërsisht për 4,879 ha, ku kanë qenë të koncentruara numër i madh i bizneseve, zonave industriale dhe tokës cilësore bujqësore, përfshirë këtu edhe Ulpianën si qendër arkeologjike. Me këtë Prishtinës i është kufizuar dukshëm potenciali për arkëtim të të hyrave vetanake dhe për zhvillim ekonomik.

Nga qeverisja komunale janë identifikuar edhe disa pengesa ligjore që po e kufizojnë hapësirën ligjore dhe institucionale për një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm ekonomik të komunës, zhvillimin e infrastrukturës publike dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Zhveshja e Komunës nga disa kompetenca ne menaxhimin e një pjesë e aseteve e ka vështirësuar menaxhimin e zhvillimit të komunës dhe mundësinë që të bëjë alokime hapësinore e funksionale konform kërkesave të institucione vendore e ndërkombëtare dhe të qytetarëve e asociacioneve të tyre (Për shembull, heqja e inspektionit të tregut, regjistrimit të bizneseve, problemet me ligjin e ndërtimit dhe taksat ndërtimore etj). Është nevojë urgjente adresimi i zgjidhjeve ligjore e institucionale që komunës do t'i mundësojnë kryerjen e funksioneve vitale të saj në këta sektorë siç është problemi i pamundësisë së shfrytëzimit të tokës komunale ne menaxhim të AKP-së, statusit të Pallatit të Rinisë, pjesëmarrjes proporcionale të përfaqësuesve të qytetarëve dhe akterëve të interesit të Komunës së Prishtinës në bordet e ndërmarrjeve publike rajonale.

Kuvendi i Komunës e ka harmonizuar Statutin e Komunës dhe rregulloret përkatëse me rregullativën ligjore në fuqi. Me statut dhe rregullore komunale janë krijuar mekanizma që shoqëria civile, shoqatat e biznesit dhe qytetarët dhe akterët tjerë të interesuar të ushtrojnë ndikimin e tyre në vendimet që merren në Kuvendin Komunal dhe në nivelet tjera të qeverisjes komunale. Asnjë dokument i rëndësishëm i komunës, siç janë Buxheti vjetor i Komunës, Planet Zhvillimore, Strategjia Zhvillimore, planet rregullative, rregulloret mbi taksat dhe ngarkesat administrative, nuk merret pa diskutim paraprak publik dhe marrjen e opinionëve të qytetarëve dhe të gjithë akterëve të interesuar.



Në Prishtinë si kryeqytet, janë të koncentruara mediat kryesore publike dhe private, pastaj OJQ, organizata dhe institucione ndërkombëtare, andaj monitorimi medial dhe nga shoqëria civile në zbatimin e ligjit dhe realizimin e premtimeve të qeverisjes komunale është më i rregullt dhe më aktiv në krahasim me komunat tjera të Republikës së Kosovës. Kjo, për qeverisjen komunale dhe për qytetarët përbënë një përparësi, pasi që prania e tyre në territorin e komunës nënkupton një qasje më kritike ndaj qeverisjes komunale.

## 4. EKONOMIA

### 4.1. BUXHETI: BURIMET E TË HYRAVE DHE SHFRYTËZIMI I TYRE

Gjatë vitit 2012, Komuna e Prishtinës ka pasur një buxhet të përgjithshëm prej 63,193,317.44 € (Tabela 4.1). Burimi kryesor i të hyrave të Komunës së Prishtinës është granti qeveritar që përbënë afër 63.3 % të të hyrave të përgjithshme të Komunës dhe pjesa tjetër vjen nga të hyrat vetanake të gjeneruara nga Komuna.

**Tabela 4.1:** Burimet e të hyrave të përgjithshme të Komunës së Prishtinës për vitet 2008 dhe 2012

Përshkrimi		2008		2012	
		Të hyrat në euro	%	Të hyrat në euro	%
<b>A. Të hyrat vetanake</b>		<b>16,198,260.00</b>	<b>43.8</b>	<b>23,168,920.44</b>	<b>36.7</b>
<b>B. Granti qeveritar</b>		<b>20,754,833.00</b>	<b>56.2</b>	<b>40,024,397.00</b>	<b>63.3</b>
1	Granti i Përgjithshëm	6,466,345.00	31.2	18,201,726.00	45.48
2	Granti Stimulues	1,610,018.00	7.8	0	0
3	Granti për Shëndëtesë	3,220,036.00	15.5	6,456,728.00	16.13
4	Granti per Aresim	<b>9,458,434.00</b>	45.6	15,365,943.00	38.39
<b>Totali (A+B)</b>		<b>36,953,093.00</b>	<b>100.0</b>	<b>63,193,317.44</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Drejtoria e Financave dhe Pronës, 2013

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prishtinës në vitin 2012 ka shënuar një rritje prej mbi 71% krahasuar me vitin 2008, gjë që tregon për një potencial në rritje për të ardhmen. Megjithatë, potenciali buxhetor në të ardhmen do të varet nga Ligji për Prishtinën dhe nga qasja më objektive e ndarjes së granteve për komuna, sepse numri i madh i banorëve të cilët jetojnë në Prishtinë krahasuar me atë që del nga regjistrimi i popullsisë dhe roli i Prishtinës si kryeqytet kërkojnë kriteret më objektive të financimit për të përmbushur nevojat e projekteve të mëdha të kryeqytetit. Poashtu, vlen të theksohet se prej të hyrave të përgjithshme të të gjithave komunave në nivel të Kosovës, Komuna e Prishtinës kontribuon me 40% ndërsa participon në këtë të hyra vetëm më 16%.

Tabela 4.2 në vijim paraqet të hyrat vetanake të realizuara për periudhën 2008-2012. Kjo tabelë jep informacione se ekziston një trend i rritjes së të hyrave vetanake, gjë që përputhet me rritjen e aktiviteteve ekonomike në Komunën e Prishtinës gjatë viteve të fundit dhe njëkohësisht një ngritje e efikasitetit në rritjen e të hyrave vetjake. Rritja e të hyrave vetjake në vitin 2012 krahasuar me vitin 2008 është 43%. Rritje më të madhe gjatë kësaj periudhe kanë pasur sidomos në të hyrat nga lejet e ndërtimit (me një rritje të konsiderueshme prej 81% krahasuar me vitin 2008), të cilat pritet të vazhdojnë këtë trend edhe në të ardhmen dhe kryesisht janë rezultat i aktiviteteve të shtuara të komunës lidhur me zbatimin e planeve rregulluese. Një prej sfidave mbetet rritja e arkëtimit të tatimit në pronë dhe rritja e të hyrave nga shfrytëzimi i pronave publike.

**Tabela 4.2: Të hyrat vetanake të realizuara të Komunës së Prishtinës për vitet 2008-2012**

Nr	Pershkrimi	2008		2009		2010		2011		2012	
		Realizuar	%	Realizuar	%	Realizuar	%	Realizuar	%	Realizuar	%
1	Leje ndërtimi	7,626,400.00	47.08	8,754,300.00	50.60	8,564,365.87	45.55	8,952,260.62	47.45	13,856,425.00	59.81
2	Tatimi në pronë	4,094,300.00	25.28	4,209,100.00	24.33	3,776,196.53	20.09	3,844,124.03	20.38	3,854,074.00	16.63
3	Licenca për biznes	542,400.00	3.35	538,700.00	3.11	745,461.00	3.97	450,984.00	2.39	289,551.00	1.25
4	Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike	648,900.00	4.01	825,500.00	4.77	799,875.50	4.25	890,580.19	4.72	822,875.00	3.55
5	Te hyrat nga kadastra	541,800.00	3.34	431,000.00	2.49	417,024.60	2.22	344,625.00	1.83	477,569.00	2.06
6	Transaksioni i pronës	836,400.00	5.16	700,400.00	4.05	677,100.00	3.60	587,290.00	3.11	631,560.00	2.73
7	Te hyrat nga inspeksioni	88,400.00	0.55	102,800.00	0.59	115,000.88	0.61	65,135.00	0.35	37,742.00	0.16
8	Administrata	179,200.00	1.11	195,100.00	1.13	336,834.00	1.79	235,742.00	1.25	239,072.00	1.03
9	Taksa rrugore	-	-	408,400.00	2.36	398,722.00	2.12	441,249.52	2.34	453,440.00	1.96
10	Arsimi	-	-	837,800.00	4.84	1,129,040.21	6.01	1,130,123.25	5.99	1,144,944.00	4.94
11	Shëndetësia	1,095,771.00	6.76	200,000.00	1.16	193,900.00	1.03	195,214.50	1.03	192,941.00	0.83
12	Te hyrat nga trafiku	397,487.00	2.45	-	-	995,579.68	5.30	723,873.70	3.84	287,361.00	1.24
13	Participimet/Donacione	81,902.00	0.51	35,939.00	0.21	215,000.00	1.14	58,477.95	0.31	10,539.00	0.05
14	Te hyrat nga hortikultura	-	-	-	-	163,789.00	0.87	370,019.00	1.96	362,896.00	1.57
15	Të tjera	65,300.00	0.40	60,900.00	0.36	273,010.94	1.45	576,122.81	3.05	507,931.44	2.19
16	<b>Gjithsej</b>	<b>16,198,260.00</b>	<b>100.00</b>	<b>17,299,939.00</b>	<b>100.00</b>	<b>18,800,900.21</b>	<b>100.00</b>	<b>18,865,821.57</b>	<b>100.00</b>	<b>23,168,920.44</b>	<b>100.00</b>

Burimi: Drejtoria e Financave dhe Pronës, 2013

Në Tabelen 4.3 është paraqitur realizimi i buxhetit të Komunës së Prishtinës në periudhën 2008-2013. Në buxhetin për paga dhe mëditje nuk vërehen ndryshime domethënëse gjatë këtyre viteve. Janë rritur investimet kapitale, sidomos në infrastrukturë (rrugë urbane dhe rurale, kanalizime, Arsim, Shëndetësi, Kulturë, Rini dhe Sport). Në krahasim me vitin 2008 në infrastrukturë dhe shërbime publike (zgjërim të sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtje të rrugëve, ndriçim publik etj) investimet janë rritur 2.6 herë, në arsim investimet për këtë periudhë janë rritur për 65%, kulturë, rini dhe sport për 3.5 herë, në shëndetësi për 2.2 herë.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime të mëdha në ndërtimin e hapësirave të reja shkollore, në kompletimin e rrjetit të qendrave të mjekësisë familjare, në ndërtimin e rrugëve në të gjitha pjesët e qytetit dhe në të gjitha fshatrat, zgjërimin e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe rregullimin e parqeve me kënde për fëmijë si dhe në ndërtimin e infrastrukturës për të rinj, terreneve sportive, bibliotekës dhe subvencionimit të veprimtarisë krijuese të të rinjëve.

**Tabela 4.3.** Realizimi i buxhetit për periudhën 2008-2012

Nr.	Përshkrimi i programeve	2008	2009	2010	2011	2012
1	Zyra e Kryetarit	45,646	203,813	34,145	44,284	46,661
2	Administrata dhe Personeli	3,398,193	5,436,922	4,832,852	6,070,759	5,441,107
3	Inspekcioni	269,123	145,661	177,455	199,489	226,002
4	Prokurimi	16,611	18,065	22,234	24,495	25,691
5	Zyra e Kuvendit të Komunës	-	-	154,982	159,743	159,746
6	Buxhet dhe Financa	3,970,535	205,560	235,999	272,835	975,314
7	Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjca dhe Infrastruktura Rrugore	7,273,494	15,359,955	14,357,158	20,444,984	19,047,810
8	Zyra e Komuniteteve	295,448	490,511	546,842	210,209	19,845
9	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural*	1,175,509	96,951	103,548	310,614	283,812

10	Zhvillim Ekonomik	26,840	579,936	42,858	95,217	107,168
11	Kadastër dhe Gjeodezi	111,437	140,583	116,091	793,775	293,126
12	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	1,000,233	1,947,660	733,392	962,917	280,508
13	Kujdesi Primar Shendetësor	3,615,507	5,520,630	6,193,762	7,466,704	8,018,029
14	Kultuë,Rini dhe Sport	405,010	1,626,509	1,275,936	1,438,647	1,440,105
15	Arsim dhe Shkencë	12,819,802	15,748,055	19,130,064	19,758,673	21,169,136
<b>Total</b>		<b>34,423,388</b>	<b>47,520,811</b>	<b>47,957,318</b>	<b>58,253,345</b>	<b>57,534,060</b>

*Burimi:* Drejtoria e Financave dhe Pronës, 2013

*\*Në kuadër të drejtorisë Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në vitin 2008 janë përfshirë projektet që kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve rurale, infrastrukturës lokale prandaj vlera e realizuar për këtë vit është më e madhe se vitet pasues.*

## 4.2. BIZNESET DHE RRETHINA KONKURRUESE

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në Komunën e Prishtinës operojnë rreth 13,000 biznese aktive prej të cilave rreth 9,542 ndërmarrje janë me pronësi private (Tabela 4.4). Numri i ndërmarrjeve në Komunën e Prishtinës, sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në vitin 2011 ka qenë afër 28,000 gjë që tregon për një shkallë të lartë të informalitetit por edhe të dështimit të firmave (Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, 2012). Numri më i madh i këtyre bizneseve janë të orientuara në veprimtari tregtare. Bazuar në të dhënat e ATK-së për ndërmarrjet aktive të prezantuara në Tabelën 4.4, rreth 54% e bizneseve merren me tregti dhe hoteleri, 15% me transport, 8% me patundshmëri dhe vetëm 4% me veprimtari përpunuese. Kjo tregon për një shpërndarje jo shumë të volitshme sipas sektorëve të bizneseve në Komunën e Prishtinës. Megjithëse, sektori i tregtisë dhe hotelerisë është sektor intensiv sa i përket punësimit (për të cilën gjë ka shumë nevojë në Prishtinë, për shkak të papunësisë dhe koncentrimit të madh të popullsisë), është e nevojshme që bizneset të nxiten në veprimtari që janë të natyrës prodhuese dhe potencialisht eksportuese. Kjo do ta zvogëlonte deficitin e madh tregtar të Kosovës dhe do të kishte efekte të tjera multiplikuese në vend.

**Tabela 4.4:** Shpërndarja e bizneseve private aktive, sipas veprimtarisë në Komunën e Prishtinës, 2012

Përshkrimi	Numri	%
Arsimim	138	1.45
Energjia elektrike, gazi dhe uji	38	0.40
Hotelet dhe restorantet	956	10.02
Kujdesi Shëndetësor, trajtimi i ujërave ndotëse dhe asistencë sociale	234	2.45
Ndërtimtaria e ulët dhe e lartë dhe punë të tjera të instalimeve në kuadër të tyre	728	7.63
Nxjerrja e mineraleve dhe gurthyesit	49	0.51
Organizatave dhe trupat ndërkombëtare	62	0.65
Patundshmëritë dhe dhenja me qira e tyre	189	1.98
Prodhimi	738	7.73
Riciklimi i mbeturinave metalike dhe jometalike	38	0.40
Shërbime financiare	63	0.66
Shërbime të ndryshme profesionale	1478	15.49
Shërbime të tjera	376	3.94
Transport	560	5.87
Tregtia me pakice	1825	19.13
Tregtia me shumice	1516	15.89
Veprimtarite artistike, zbavitëse dhe rekreative	338	3.54
Veprimtarite e organizatave të ndryshme	110	1.15
<b>Gjithsej</b>	<b>9542</b>	<b>100.00</b>

*Burimi:* Ndërmarrjet aktive sipas Administratës Tatimore të Kosovës, Ministria e Financave.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm në tremujorin e parë të vitit 2013 në Prishtinë janë krijuar 817 ndërmarrje të reja që përbën 26.3% të numrit të përgjithshëm të bizneseve të reja në nivel të Kosovës. Kjo tregon për një aktivitet të shtuar të aktiviteteve ndërmarrëse në Komunën e Prishtinës në raport me komunat tjera të Kosovës.

Aktivitetet ekonomike shërbyese që përbëjnë edhe përparësinë konkurruese të Prishtinës janë kryesisht të koncentruara në hapësirën urbane të qendrës dhe në zonat urbane të lagjeve: “Dardania”, “Ulpiana”, “Kodra e Diellit”, “Lakërishta”, “Qendra” dhe “Aktashi”. Në zonën e Qendrës dominojnë institucionet administrative të pushtetit qendror dhe lokal, hotelet, restorantet, bankat, objektet kulturore, lokalet tregtare me pakicë dhe selitë e zyrave të bizneseve të ndryshme. Organizimi hapësinor i Qendrës ruan vlerat dhe standardet urbane të realizuara kryesisht në periudhën e paraluftës, ndërsa pas luftës kemi fenomenin e shndërrimit të hapësirave banesore në përdhësë dhe të kateve të para të banesave kolektive, në lokale afariste për qëllime komerciale. Në zonat e tjera të urbanizuara në kuadër të veprimtarive terciare ushtrohet aktivitet i llojllojshëm i shërbimeve duke dominuar tregtia me pakicë dhe restorantet. Me plane rregulluese të miratuara për lagjet: “Qendra 1”, “Qendra 2”, “Dodona”, “Tophane”, “Kalabria”, “Mati”, “Sofalia” dhe “Lakërishta” dhe “Dardania” ka ndodhur ose parashihet zgjerim i aktiviteteve të biznesit në zonat e ndërtuara apo në ndërtim e sipër. Në vitet e fundit Komuna e Prishtinës ka luajtur në rol kyç në ofrimin e mundësive për zhvillimin panairëve në qendër të qytetit duke përkrahur kështu promovimin e bizneseve të vogla, artizanateve dhe ekonomive familjare.

Nyjat kryesore ekonomike në Komunën e Prishtinës shtrihen në aksin rrugor Prishtinë - Fushë Kosovë dhe Prishtinë - Ferizaj. Me Planin Zhvillimor Komunal si dhe me Planin Zhvillimor Urban për vitet 2013/2022+, janë definuar lokacionet për veprimtari ekonomike dhe jo-ekonomike, si: rritja e qasjes në rrjetet ndërkombëtare të transportit (lidhjet me korridoret evropiane duke pasur si qëllim lidhjen veçanërisht me korridoret V, VI, VIII dhe X), autostrada Prishtinë-Merdar, krijimi dhe kompletimi i një sistemi efektiv të komunikacionit, implementimi i tre unazave për organizimin e sistemit të transportit, përdorimi efikas i tokës bujqësore, zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, nyjat strategjike për zhvillim të ekonomive shërbyese (aksi Prishtinë-Aeroport), zona industriale ekzistuese prej 60 ha, zona ekonomike prej 600 ha si dhe Prishtina e Re me një sipërfaqe prej 1,000 ha, është bërë zgjerimi kufijve urban të qytetit në veri dhe verilindje. Poashtu, është paraparë ndërtimi i stacionit të madh intermodal për Kryeqytetin. Këto hapësira të reja do të ofrojnë mundësi shtesë për zhvillimin e biznesit sipas standardeve më të mira.

Me PZHU janë të detajuara sidomos dy zonat industriale. Zona ekzistuese industriale që shtrihet në aksin rrugor Prishtinë – Fushë Kosovë, me një sipërfaqe neto prej 60 ha. Zona ekonomike është në veri-perëndim të Prishtinës, me një sipërfaqe të tërësishme prej 600 ha (pa zbritur korridoret për infrastrukturën teknike) është vetëm hapësirë e identifikuar, e pa ndërtuar dhe pa infrastrukturë përcjellëse. Për zhvillimin e kapaciteteve industriale në këtë zonë, prioritet duhet dhënë aktiviteteve ekonomike që bëjnë punësim më të madh, janë industri të pastra, nuk janë harxhues të mëdhenj të energjisë elektrike dhe të ujit industrial. Nuk ekzistojnë të dhëna apo studime lidhur me strukturën e punësimit apo të dhëna më të detajuara lidhur aktivitetin ekonomik në komunë.

## **4.3. ZHVILLIMI RURAL**

### **GJEOGRAFIA**

Sipërfaqja e komunës është rreth 523 km<sup>2</sup> prej të cilave 60 km<sup>2</sup> i takojnë zonës urbane të komunës (nga i gjithë territori i komunës, 20.358 ha janë tokë bujqësore, prej të cilave 14.000 ha janë tokë e kultivuar, ndërsa pjesa tjetër kullotë. Rreth 28.000 ha janë përcaktuar si pyje. Komuna e Prishtinës ka pozitë qendrore në Rrafshin e Kosovës. Zonat rurale dallohen me relief kodrinoro-malor dhe një pjesë më të vogël me territor fushor me veçori fiziko-gjeografike të përshtatshme për zhvillimin e prodhimit të bujqësore dhe jo bujqësore.

### **POPULLSIA DHE EKONOMITË FAMILJARE**

Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë më 2011, Komuna e Prishtinës ka 198,897 banorë (49.8% meshkuj dhe 50,2% femra). Në territorin e Komunës së Prishtinës janë 40.292 ekonomi familjare dhe 58.849 njësi të banimit. Prej këtyre, vetëm në pjesën rurale të Prishtinës janë 55.000 banorë, 9.700 ekonomi familjare dhe 15.300 njësi të banimit. Në zonat rurale në periferi të pjesës urbane (Matiçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sofali, Zllatar etj.) dendësia është rreth 7 njësi banimi për hektar, dhe një dendësi të popullsisë prej 35 banorë për hektar.

Vlerësimet e pasluftës të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare flasin për dyfishimin e popullsisë si pasojë e migrimeve nga pjesët rurale dhe komunat e tjera. Edhe sipas të dhënave kompanive për ofrimin e shërbimeve të ujit, rrymës dhe shërbimeve të tjera komunale rezulton se në Prishtinë gjatë javës jetojnë ndërmjet 450.000 deri në 500.000 banorë.

Në disa fshatra, sidomos ato që i takojnë Malësisë së Gollakut, vërehet lëvizje e madhe e popullatës (sidomos të rinjve) në drejtim të zonave urbane. Me këtë është zvogëluar edhe fuçia punëtore në këto fshatra. Kështu, disa fshatra të cilat kanë qenë mjaft të populluara tani kanë numër shumë të ulët të banorëve, si Nishevci, Radasheci, Kukavicë, Hajkobillë, Gllogovicë etj. Problemi i punësimit (sikurse edhe në tërë Kosovën), është njëri nga problemet më të theksuara në zonat rurale. Mundësitë e punësimit në këto fshatra janë shumë të kufizuara. Mungesa e kapaciteteve përpunuese, mungesa e mjeteve investuese për ta zhvilluar një bujqësi moderne, ka shkaktuar stagnim në disa rajone (sidomos në zonat e thella kodrinore-malore), që manifestohet me ngecjen e prodhimit bujqësor në këto rajone dhe me migrimin e popullsisë drejt rajoneve urbane (por edhe jashtë Kosovës).

### **GJENDJA E EKONOMIVE BUJQËSORE NË ZONAT RURALE**

Shumica e familjeve, sidomos atyre që jetojnë në rajonet prodhuese (ku ka mundësi të organizimit më të mirë të prodhimit të bujqësore, posedojnë sipërfaqe të tokës mjaft të vogël dhe në shumicën e rasteve të shpërndarë në disa parcela.



Ky është një element mjaft kufizues për aplikimin teknologjive bashkëkohore në prodhimtarinë bujqësore në përgjithësi. Ndërtimi i shtëpive pa plan, objekteve tjera përcjellëse (të cilat do të mund të ndërtoheshin në toka më pak cilësore), kanë bërë që fondi i tokës bujqësore të zvogëlohet në vazhdimësi.

Në rajonet kodrinoro-malore, në shumicën e rasteve (qoftë për shkak të mungesës së ujitjes, shpërnguljes së madhe të njerëzve apo edhe arsyeve tjera), këto sipërfaqe nuk janë të punuara, shfrytëzohen për kullota e në raste më të rralla hasen drithërat. Madhësia e vogël e fermës (e cila sillet në rreth 2 ha), është faktor limitues për një prodhimtari intensive bujqësore, sidomos kur kësaj i shtohet fakti se kjo pronë, zakonisht është e ndarë në disa parcela. Edhe pse që nga pas lufta, janë bërë investime mjaft serioze në infrastrukturën e këtyre fshatrave (kryesisht në rregullimin e rrugëve, ambulancave, ujësjellësit, kanalizimit, dhe shkollave etj), megjithatë problemet e grumbulluara për shumë vite në këtë lëmi kërkojnë vazhdimësi dhe zgjerim të punëve në këtë drejtim.

## **KUSHTET KLIMATIKE**

Niveli mbidetar 535-580 m me klimë kontinentale, me dimra të ftohte dhe verëra të nxehta, me mesatare të reshjeve prej 600 mm për vit. Klima e këtij rajoni është e kushtëzuar nga pozita gjeografike, ekspozicioni, relievi, lartësia mbidetare etj. Zonat rurale të Komunës së Prishtinës, karakterizohen me klimë kontinentale me ndonjë ndikim të klimës së mesme. Temperaturat mesatare vjetore, sipas të dhënave shumëvjeçare meteorologjike sillen nga 9,2-11,6 °C. Temperaturat më të ulëta mesatare hasen gjatë muajve dhjetor-janar dhe më të larta hasen në muajit Korrik-Gusht. Reshjet që bien në rajonin e Komunës së Prishtinës, nuk janë të radhitura në mënyrë uniforme gjatë gjithë vitit. Sasia e reshjeve që bie dallon shumë nga viti në vit. Reshjet më të mëdha vërehen gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor, ndërsa më të ulëta në korrik-gusht. Andaj ky element duhet pas parasysh në planifikimin e prodhimtarisë intensive bimore, sidomos prodhimin të perimeve, patates, misrit dhe bimëve industriale.

## **RESURSET UJORE**

Lumenjtë e rajonit të Prishtinës kryesisht ushqehen nga reshjet dhe shkrirja e borës. Kështu që edhe sasia e rrjedhshme e tyre varet nga sasi të rrjedhëse të ujit dhe nga sipërfaqet e pellgjeve të tyre. Për këtë arsye, sasi të mëdha (rreth 70 %) rrjedhin gjatë periudhës jashtë vegjetative (tetor-prill), ndërsa sasi të tjera (afër 30 %) rrjedhin gjatë periudhës vegjetative. Kjo edhe njëherë dëshmon faktin e renditjes së pavolitshme të reshjeve gjatë muajve të vitit mbi këtë rajon. Kështu në muajt e verës, kur kërkesat e përgjithshme të bimëve për ujë shtohen e sidomos për ujitje, shumë përroje dhe lumenjtë të vegjël thahen plotësisht, kurse në lumenjtë më të mëdhenj sasia e ujit bie në minimum. Nga një rrjedhje kaq e pavolitshme e sasive rrjedhëse të ujit nëpër lumenjtë shfaqet një mungesë e madhe e ujit për prodhimtari intensive bujqësore gjatë muajve të verës dhe në fillim të vjeshtës. Kjo mungesë e ujit paraqitet si faktorë kryesor kufizues i zhvillimit të gjithë mbarshëm

të prodhimitarisë bujqësore në rajonin e Komunës së Prishtinës, madje edhe të zgjerimit të sipërfaqeve me ujitje. Hulumtimet e kryera tregojnë se nga sasia e përgjithshme e sipërfaqeve punuese që ekziston në fshatrat e rajonit të Prishtinës vetëm 10 % e sipërfaqeve punuese ujitet, ndërsa sasia tjetër e sipërfaqeve (90 %) nuk ujitet dhe nga e njëjta realizohet prodhimtari e ulët. Një pjesë e tokës në fshatrat e rajonit të Prishtinës ujitet nga lumi i Llapit me rënie të lirë dhe në një pjesë tjetër ka mundësi të zbatohet ujitja nga hidrosistemi i Ibrit. Mirëpo, në anën tjetër shumë fshatra të këtij rajoni nuk zbatohet fare ujitja.

Për nevoja të pijes, higjienës dhe kërkesave akute banorët e Prishtinës me rrethinë, përdorin ujin nga penda, në Badovc me vëllim prej 31.6 x 106 m<sup>3</sup>, Batllavë me vëllim 35 x 106 m<sup>3</sup>, Gazivodë në shtratin e lumit Ibër etj. Mirëpo, për nevojat perspektive, afatgjate të prodhimitarisë bujqësore për ujë në rajonin e Komunës së Prishtinës për të gjitha destinimet (popullsisë, bujqësisë, industrisë, peshkatarisë etj.), është e domosdoshme të sigurohen sasi tjera të ujit përmes akumulimeve të reja.

## **PRODHIMTARIA BUJQËSORE**

Aktualisht në fshatrat e Komunës së Prishtinës, bujqësia është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë. Megjithatë, prodhimi bujqësor në këtë rajonrajon është mjaft i ulët në raport me kushtet agroekologjike që posedon ky rajon, potencialeve të mundshme prodhuese dhe produktivitetit përkatës që haset në vendet e zhvilluara. Prodhimtaria bujqësore, dallohet, përveç tjerash edhe me investimet paraprake relativisht të larta, dhe kthimin e tyre për një periudhë relativisht të gjatë. Duke i ditur vështirësitë e banorëve të fshatrave, është i njohur fakti se mundësitë e tyre për investime diç më serioze janë fare të vogla.

Fshatrat e Komunës së Prishtinës, në raport me vendet tjera me produktivitet të lartë të punës në prodhimtarinë bimore primare, realizojnë rendimente të ulta të prodhimit. Faktorët që ndikojnë në realizimin e rendimenteve të ulta janë të shumtë, nga të cilët për këtë rajonrajon mund t'i veçojmë: niveli i zbatimit të ulët në teknologjinë e prodhimitarisë, përdorimin e farërave dhe inputeve tjera jo cilësore, mungesa e lagështisë gjatë periudhës së vegjetacionit, sidomos për misër, jonxhë dhe bimë industriale (rregullariteti jo i drejtë i reshjeve gjatë vitit dhe deficitit i tyre gjatë periudhës vegjetative) etj.

*Prodhimtaria bimore* në rajonrajonin e fshatrave të Prishtinës është e strukturuar ngjashëm me atë në nivel vendi. Dominim absolut kanë drithërat. Llogaritet se me drithëra dhe bimë industriale në komunën e Prishtinës, çdo vit mbillen rreth 1.733 ha. Rendimentet e realizuara, tregojnë se potencialet prodhuese të kultivarëve dhe hibrideve bashkëkohore të këtyre bimëve shfrytëzohen në shkallë shumë të ulët (rreth 30 %). Struktura e kultivarëve dhe hibrideve që përdoren për mbjelljen e drithërave në rajonin e Komunës së Prishtinës është mjaftë heterogjene, porse shfrytëzimi i tyre nuk përkon me potencialet prodhuese që kanë. Rendimentet mesatare janë të ulëta, ato nuk dallon shumë nga mesatarja e përgjithshme vendore (3-3,5 t/ha varësisht nga fshati)

*Kultivimi i perimeve* në fshatrat e Komunës së Prishtinës është mjaft heterogjen. Në fshatrat e pjesës perëndimore dhe jug-perëndimore (kryesisht ato që shtrihen për gjatë lumit Llap), kjo prodhimtari është më e avancuar dhe për të ekziston një traditë relativisht e mire. Në një të kaluar jo shumë të largët, këto fshatra madje kanë qenë furnizuesit më të rëndësishëm të Prishtinës me perime dhe patate. Në rajonet tjera prodhimi perimeve bëhet kryesisht në parcela të vogla, kryesisht për nevoja të familjes. Shumë rrallë mund të haste prodhim për treg i këtyre kulturave bujqësore. Me perime të ndryshme janë të mbjella 271 ha.

*Sektori i Pemëtarisë*, në fshatrat e Komunës së Prishtinës, është njëri prej sektorëve i cili përballet me vështirësi të natyrave të ndryshme. Në shumicën e rasteve, banorët e këtyre fshatrave, kultivimin e pemëve e bëjnë në kopshte për rreth shtëpive, në sipërfaqe të vogla, kryesisht për nevoja të familjes. Prodhimi për treg është tepër i rrallë. Gjatë viteve të fundit komuna ka siguruar përkrahje të rëndësishme për këtë sektor. Si rezultat, llogaritet se janë rreth 120 ha me pemishte.

*Blegtorinë*, në rajonin e fshatrave të Prishtinës e karakterizojnë: gjendja numerike e fondit blegtoral dhe përbërja racore. Në ripërtëritjen e fondit të bagëtisë deri me tani ndihmuan edhe disa OJQ.

Në gjedhtari përbërja racore në shumë fshatra akoma vërehet se është ekstensive dhe jo rrallë hasen raca ekstensive si: p.sh. busha që karakterizohet me një produktivitet të ulët. Mirëpo në vitet e fundit vërehet një përmirësim racor.

Livadhet e këtyre fshatrave kositen (në shumicën e rasteve) vetëm një herë, nuk plehërohen (si pasojë e mungesës së mjeteve materiale të fermerëve) dhe të njëjtat janë të ekspozuara në kushtet e prodhimtarisë aride (pa ujitje). Shfrytëzimi i tyre aktualisht është mjaftë ekstensiv dhe nuk përkon me kërkesat e zhvillimit intensiv të bimëve foragjere dhe blegtorisë. Sa u përket kullotave shfrytëzimi i tyre është ekstensiv, me kullotje të lira dhe të pa organizuara nga bagëtia.

Fshatrat e këtij rajoni kanë kushte të mira të merren me mbajtjen dhe kultivimin e suksesshëm të kategorive tjera të bagëtisë si: deleve, dhive dhe shpezëve. Megjithatë numri i krerëve të këtyre kafshëve është mjaft i vogël, krahasuar me mundësitë që ofron ky rajon.

## **AKTIVITETET JO BUJQËSORE**

Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, dhe kufizimet tjera, vërehet se është shumë e nevojshme që në zonat rurale të Prishtinës, një rëndësi të posaçme duhet kushtuar nxitjes së kulturës ndërmarrëse dhe zhvillimit edhe të bizneseve jo bujqësore, që do të thotë bizneseve familjare komplementare. Në këtë drejtim ka shumë pak aktivitete qoftë nga banorët e zonave rurale apo edhe nga institucionet të cilat duhet përkrahur këto aktivitete, të paktën në fazat fillestare. Këto aktivitete do të ndikojnë shumë në rritjen e punësimit dhe rritjen e përgjithshme të mirëqenies në zonat rurale. Këto aktivitete përfshijnë përpunimin

e drurit, pastaj përpunimi i produkteve bujqësore, biznese për grumbullimin e kërpudhave dhe fryteve tjera pyjore, bletaria, bimët mjekuese, etj. Përpunimi i produkteve bujqësore është fare i vogël. Një mundësi tjetër, që është pothuajse e pa njohur për banorët e këtyre zonave ka të bëjë me turizmit rural, për zhvillimin e të cilit në disa rajone rurale të Prishtinës ka kushte shumë të favorshme.

## **PYJET**

Rajoni i Komunës së Prishtinës përkufizohet me masive të shprehura pyjore të cilat kanë hidrografi të theksuar, kryesisht janë gjethegjëra dhe përfshijnë një sipërfaqe prej rreth 28.000 ha. Karakteristikë e fshatrave të këtij rajoni janë malet e ulta dhe të mesme të cilat hasen në lindje. Sipërfaqet me pyje paraqesin resurse natyrore dhe është obligim i të gjithë faktorëve të ndërlidhur të angazhohen në efikasitetin e tyre dhe përdorimin e qëndrueshëm të këtyre resurseve në të mirë të banorëve të rajonit të Prishtinës. Kjo para së gjithash duhet të përfshijë ndalimin e prerjeve të egra të tyre, duke respektuar strukturat administrative shtetërore për përdorimin efikas të pyjeve dhe ngritjen e vetëdijes së banorëve për rëndësinë e pyjeve dhe industrisë pyjore.

Për shkak të nevojave për dru djegëse dhe lëndë ndërtimore, pyjet e rajonit të Prishtinës janë mjaftë të shkatërruara dhe ky shkatërrim po vazhdon në kontinuitet duke u degraduar kështu sipërfaqe të mëdha pyjore. Ndihet nevoja e pyllëzimit të sipërfaqeve të reja.

## **5. ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Në ofrimin e shërbimeve publike, Komuna kryesisht është ballafaquar me sfidat e furnizimit me ujë, funksionimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, gjetjen e zgjidhjeve për trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe trotuareve të qytetit dhe rrugëve lokale, ndriçimin publik, semaforët dhe transportin publikë dhe detyra tjera të lidhura me drejtoritë dhe shërbimet e tjera.

Ofrimi e disa shërbimeve publike, siç është rasti me ujin dhe energjinë elektrike, është në përgjegjësi të kompanive publike, të cilat në mënyrë korporative i takojnë qeverisjes qendrore. Prandaj vendimet për investime në këto fusha merren jashtë ndikimit të qeverisjes lokale.

### **5.1. FURNIZIMI ME UJË (KUR PRISHTINA) DHE KANALIZIMI**

Furnizimi me ujë është shërbim në menaxhim të KUR "Prishtina" (Kompania e Ujësjellësit Rajonal), e cila kompani është nën mbikëqyrjen e nivelit qendror e cila, ka për obligim furnizimin e rregullt të qytetarëve me ujë të pijshëm, përpunimin, pastrimin dhe përcjelljen e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, por edhe

ndërtimin e rrjetit për furnizim me ujë dhe njëkohësisht rrjetit të kanalizimit. Për më shumë, momentalisht komuna në bashkëpunim me KUR "Prishtina", është duke u përgatitur për fillimin e realizimit të projektit mbi ndërtimin e impiantit e ujërave të zeza në liqenin e Badocit, projekt ky i cili mbështet financiarisht nga ambasada Çeke.

Prishtina furnizohet me ujë nga burime sipërfaqësore kryesisht nga akumulacionet artificiale të Badocit, Batllavës si dhe nga disa burime nëntokësore të lokalizuara në Komunën e Fushë Kosovës. Sipas të dhënave të vitit 2004 prodhimi vjetor i ujit për pije është 38,995,832 m<sup>3</sup> ujë/vit. Konsumi ditor për banorë vlerësohet të jetë 90 litra. Afer 90 % e popullsisë së komunës është e mbuluar me rrjetin e ujësjellësit. Sasia ekzistuese e ujit në përdorim nuk plotëson nevojat e qytetarëve për ujë të cilat dita ditës po shenojnë rritje.

Vlerësohet se zonat urbane të Prishtinës pothuajse është e kyçur në sistem të kanalizimit përderisa zonat rurale nuk janë të lidhura në sistem. Rrjeti i kanalizimit është pjesërisht i dëmtuar përderisa në periferi të qytetit i njejt raportohej të jetë jo-funksional. Aktualisht nuk ekziston asnjë impiant i cili do të pastronte ujërat e zeza në komunë. Ujërat e zeza përmes rrjetit ekzistues derdhen në lumin Prishtina, Vellusha si dhe në përrojet periferike të qytetit. Ata që janë jashtë rrjetit të kanalizimit janë të lidhur me lumenjë dhe përrenjë të vegjël, kanë në përdorim gropat septike ose uji i ndotur rrjedh në mënyrë të pakontrolluar në tokë.

Gjatë kësaj periudhe janë marrë masa konkrete në përmirësimin e furnizimit me ujë. Po realizohet projekti me Komisionin Evropian, Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), Komunën dhe Qeverinë e Kosovës për rekonstruktimin e rrjetit të ujësjellësit në tërë territorin e qytetit dhe për ndërtimin e fabrikës së re të ujit. Projekti i rekonstruktimit, i cili ka hy në vitin e tretë kap një shumë prej rreth 25 milion euro, kurse ai i ndërtimit të fabrikës së re të ujit në Shkabaj parahihet të jetë mbi 30 milion euro. Prandaj, furnizimi i rregullt dhe cilësor 24 orë planifikohet të bëhet me ndërtimin e fabrikës së ujit në Shkabaj. Këtë vit do të bëhet kompletimi i projektit dhe shpronësimi i pronave në vendin ku do të ndërtohet fabrika, kurse projekti pritet të realizohet deri në vitin 2016.

## **5.2. MENAXHIMI I MBETURINAVE (KRM "PASTRIMI")**

Grumbullimi i mbeturinave të amvisërisë dhe bizneseve në komunën e Prishtinës, është në përgjegjësi të Ndërmarrjes komunale "Pastrimi", e cila në pikëpamje të qeverisjes korporative është në pronësi të Prishtinës me rreth 80%. Grumbullimi i mbeturinave përfshinë në tërësi zonën urbane dhe 12 fshatra të komunës së Prishtinës. Kompania Pastrimi ka rritur efikasitetin e funksionimit të saj sa i përket mbledhjes së mbeturinave urbane, mirëpo përballet me arkëtim të ulët nga ana e qytetarëve dhe bizneset, edhe pse çmimi për mbeturina nuk është i lartë. Njëri nga problemet me të cilat ballafaqohet kjo organizatë është ai i derdhjes së mbeturinave në deponinë rajonale në fshatin Mirash, e cila deponi menaxhohet

nga niveli qendror, kurse aplikon çmime të papërballueshme për kompaninë Pastrimi dhe nuk plotëson kushtet sipas standardeve.

Komuna e Prishtinës ka mbështetur pajisjen e kësaj kompanie me kontenjerë dhe blerjen e kamionëve dhe pajisjeve tjera. Kompania po ashtu është mbështetur nga agjencioni Japonez për Zhvillim Ndërkombëtr - JICA me 10 kamionë për bartje të mbeturinave.

Për më shumë, me blerjen e 450 kontejnerëve të rinj, sivjet komuna do të fillojë pilot projektin për ndarjen e mbeturinave të amvisërisë nga plastika, metali, letra dhe qelqi. Komuna e Prishtinës ka hartuar edhe projektin për deponinë e mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, i cili projekt do të zgjidhte problemin e grumbullimit të të gjitha mbeturinave që dalin nga ndërtimet dhe rrënimet e objekteve të ndryshme. Te gjitha projektet të cilat do të realizohen, janë projekte të cilat kanë për qëllim pastrimin si të qytetit ashtu edhe të fshatrave të komunës së Prishtinës.

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave Komuna ka bashkëpunuar shumë edhe me GIZ-in, si për studimin e gjendjes së mbeturinave, ku janë bërë analizat për verifikimin e sasisë dhe llojit të mbeturinave, përgatitja e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, fillimi i pilot-projektit për ndarjen e mbeturinave në lagjen Dardania, fushata për vetëdijesimin e qytetareve dhe bizneseve për trajtimin dhe ndarjen e mbeturinave. GIZ ka dhënë donacione për kontejnerë, shporta, kamion për bartje të mbeturinave, pajisje, inventar dhe teknologji si për DSHP ashtu edhe për KRM "Pastrimi". Vlen të përmendet po ashtu edhe investimi që GIZ ka bërë në funksionalizimin e Sistemit për menaxhimin e financave për KRM "Pastrimi", si dhe organizimin e vizitave studimore për marrjen e praktikave më të mira në menaxhimin e mbeturinave.

### **5.3. MIRËMBAJTJA VERORE DHE DIMËRORE E RRUGËVE DHE TROTUAREVE.**

Gjatë vitit 2012 janë mirëmbajtur 295 rrugë lokale nga gjithsej 477 rrugë të emëtuara të kategorive të ndryshme, të cilat janë të qarkullueshme në Komunën e Prishtinës. Gjatë vitit 2012 janë emërtuar edhe 177 rrugë të reja duke e rritur numrin e rrugëve të emëtuara në 654.

Në vitin 2013 janë planifikuar të shpenzohen 895,600.30 Euro për mirëmbajtje verore të rrugëve. Përveç këtyre janë përfshirë edhe parkingje, hapësira publike, shtigje për këmbësorë etj.. Përveç në zonën urbane, komuna bënë edhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale të rendit të katërt (ato të shtruar me zhavorr), por edhe pastrimin e portave hyrëse të lumenjve dhe shtratit të tyre. Komuna po ashtu bënë edhe mirëmbajtjen dimërore për rrugë të qytetit dhe fshatrave.

## 5.4. NDRIÇIMI PUBLIK

Komuna e Prishtinës ka punuar dukshëm sa i preket ndriçimit publikë. Me projektet të cilat priten të realizohen me këtë strategji pritet që të mbulohet i gjithë territori me ndriçim. Kështu në bazë të raportit vjetor 2012, vetëm vitin e kaluar janë investuar 182,000 euro për mirëmbajtje në ndriçimin e gjithsej 328 rrugëve dhe 52 hapësirave publike të komunës së Prishtinës. Komuna e Prishtinës ka investuar në zgjerimin e ndriçimit të 53 rrugëve urbane dhe rurale dhe ndriçimin i parqeve (Parku Ulpiana, Parku i ri Dardania, Parku Afrim Zhitia, Parku Vëllezërit Gërvalla, Parku Ulpiana pjesa përball konvikteve, Parku Arbëria). Është bërë riparimi i mbi 80% i ndriçimit të ulët të sipërfaqeve të gjelbëruara. Është bërë ndriçimi i 26 shkollave me reflektor, ndërrimi i 1,000 trupave ndriçues LED, riparimi i ndriçimit të lartë dhe ndërrimi i poqave në ato ekonomike, riinstalimi i ormanëve të ndriçimit publik (80 copë), si dhe janë vendosur 2,280 trupa ndriçues. Dëmtimi i ndriçimit publik, si dhe ndërhyrja e personave të pa autorizuar në pikat komanduese të ndriçimit, në njërin anë dhe buxheti i vogël në krahasim me rritjen e qytetit, në anën tjetër, janë disa nga problemet me të cilat ballafaqohet ky sektor gjatë kryerjes së detyrave të veta.

## 5.5. SEMAFORËT

Komuna ka arritur të mbulojë nyjat kryesore brenda qytetit me semaforë të teknologjisë së lartë. Dy vitet e fundit komuna ka investuar në nyje të reja semaforike dhe në zhvendosjen e nyjeve të vjetra, është bërë identifikimi i të gjitha pikave në qytet ku ka nevojë për semaforë dhe është realizuar një nivel më i lartë i menagjimit të këyre nyjeve. Vënja e semaforëve po tregohet e suksesshme në stabilizimin e qarkullimit të automjeteve në qytet dhe në rritjen e sigurisë së qytetarëve në komunikacion..

## 5.6. TRANSPORTI PUBLIK

Për organizimin e transportit publik të udhëtarëve, Komuna e Prishtinës ka të hartuar Rregulloren për organizimin e transportit rrugor dhe Rregulloren për caktimin e linjave dhe itinerarit në territorin e komunës së Prishtinës. Në përgjithësi, transporti i udhëtarëve realizohet me autobus dhe vetura taxi. Transporti me autobus kryhet në zonën urbane dhe urbano-periferike të organizuar në 37 linja, prej tyre 15 janë linja urbane dhe 22 linja urbano-periferike. Linja 1 (Fushe Kosove-Prishtine) dhe linja 2 (Obliq-Prishtine), janë të organizuara me marrëveshje ndër-komunale. Deri më tani, operatorët që kryejnë transportin e udhëtarëve janë nga sektori publik dhe më shumë nga ai privat. Nga 37 linjat e caktuara për transportin e udhëtarëve per NPK "Trafiku Urban" janë ndarë 13 linja, kurse linjat tjera mbulohen nga operatorët privat. NPK "Trafiku Urban" si ndërmarrje disponon infrastrukturën, parkingun për autobus, garazhen dhe oficinën për servisim, mirëpo i mungojnë kapacitetet (autobusët), ndërsa në anën tjetër, sektori privat ka



numër të mjaftueshëm të autobusëve. Në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi, komuna në bashkëpunim me USAID-in janë duke hartuar projektin për modernizimin e transportit publik, i cili është në fazën e studimit të fizibilitetit. Po ashtu komuna planifikon të investoj në menaxhimin më të mirë të trafikut urban dhe në pajisjen me autobusë të rinj.

## **5.7. STACIONI I AUTOBUSËVE**

Me vendim të AKP-së, kompania publike “Stacioni i autobusëve” ka kaluar në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe në menaxhim të plotë nga kjo komunë. Është zgjedhur bordi i drejtorëve nga komisioni i aksionarëve i Komunës së Prishtinës dhe është në procedurë e sipër zgjedhja e drejtorit menagjues. Komuna do të hartoj një program të veçantë me të cilin do të përcaktoj qartë interesin publik që popullata duhet ta ketë nga kjo kompani.

## **5.8. HAPËSIRAT GJELBËRUESE DHE AMBIENTI**

Komuna Prishtinës çdo vit ka punuar në rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese, duke kultivuar bimë dekorative sezonale dhe shumëvjeçare. Deri me tani janë ngritur 100 ha sipërfaqe gjelbëruese, përfshirë këtu mirëmbajtjen e parqeve, si: Parku i Arbërisë, Parku i Qytetit, Parku në Tauk Bashqë dhe Parku i Gërmisë (zona e tretë për rekreacion, lëndina), si dhe ngritje të sipërfaqeve të reja gjelbëruese në lagjen: Dardania, Ulpiana, Kodra e Diellit, zona Qendër, Arbëri dhe Kalabri. Gjatë vitit 2012 për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara dhe ngritjen e hapësirave të reja gjelbëruese janë shpenzuar 800.000€, duke u kushtuar kujdes të veçantë parqeve në qytet. Vetëm parku i Arbërisë ka kushtuar 200,000€, investim ky i bërë si donacion nga Komisioni Europian, dhe implementuar nga IOM-i. Ndërsa, për vitin 2013 kujdes i është kushtuar investimit në rregullimin dhe rigjenerimin e parkut në Fidanishte dhe Taukbahqë në vlerë prej 500.000€. Përveç kësaj, komuna në bashkëpunim me Komisionin Europian ka planifikuar edhe rregullimin e parkut të Gërmisë, i cili investim kap vlerën prej 510.000€. Për më shumë, projekti për mbjelljen e drunjëve dekorative, në tërë qytetin është një projekt i cili ka filluar në prill me një investim prej 300.000 € me 1300 druj të cilësisë së lartë. Po ashtu në vjeshtën e këtij viti planifikohet të mbillen edhe rreth 1500 drunj, me një kosto prej rreth 300,000 euro, duke vazhduar me këtë tempo çdo vjeshtë deri në vitin 2016.

Në aspektin e gjelbërimit të qytetit duhet bërë të gjitha përpjekjet që hapsira aktuale prej 1.90 m<sup>2</sup> të dyfishohet së paku dhe posaçërisht në zonat e qendrës së qytetit. Gjelbërimi dhe mbrojtja e ambientit është një nder sfidat më të rënda me të cilat duhet të merret strategjia vijuese. Posaçërisht krijimi i hapësirave të reja në kuadër të pjesëve të ndërtuara të qytetit është detyrë që duhet të dallohet në strategjitë vijuese.



## 5.9. ENERGJIA ELEKTRIKE

Duke marrë parasysh trendet prezente të zhvillimit, për të ardhmen pritet që Komuna e Prishtinës të përballlet me kërkesa të shtuara për energji elektrike. Në mungesë të koordinimit të veprimeve dhe aktiviteteve, strukturat komunale e kanë pasur të vështirë bashkeveprimin dhe sinkronizimin e projekteve me strukturat rajonale përgjegjëse të furnizimit me energji. Si pasojë duhet të behet rishikimi i projekteve zhvillimore dhe të ridimensionohen nevojat për energji elektrike në zonat në veçanti dhe të tërë qytetit në përgjithësi.

Pos analizës së konsumit të energjisë sipas kategorisë së konsumatorëve (grupet tarifore) nuk ekziston një projeksion e nevojave për energji elektrike në një periudhë më të gjatë. Edhe pse në planin zhvillimor për periudhën 2013-2016 iu është dhënë një vend i posaqem transportit në bazë të energjisë elektrike (hekurudha, trenat e lehtë dhe trolebusat) mungon analiza e nevojës për energji dhe infrastrukturë përkatëse.

## 5.10. FURNIZIMI ME NGROHJE QENDRORE DHE UJË TË NGROHTË

NPK "Termokos" është ndërmarrja që bënë furnizimin e qytetarëve me ngrohje qendrore. Për shkak të pozitës së rëndë financiare me të cilën është ballafaquar kjo kompani, si rezultat i menaxhimit të mëhershëm, lëvizjes së çmimeve në berzën ndërkombëtare dhe mospërcjelljen e këtyre lëvizjeve me çmime të brendshme, komuna dhe Qeveria qendrore kanë mbështetur Termokosin me subvencione për të siguruar një pjesë të mazutit për ngrohje.

Projekti për ko-gjenerim është një nga zgjidhjet afatgjate për ngrohje dhe ujë të ngrohtë. Pasi që është nënshkruar marrëveshja me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Ministrinë e Financave për projektin e ko-gjenerimit për ngrohje të qytetit nga avulli i KEK-ut, ky projekt ka filluar së zbatuari. Në këtë projekt, Komuna ka participuar me 2 milionë €, si dhe do të garantojë me 5 milion euro për investimet që KfW do të bëjë në "Termokos". Projekti pritet të realizohet dhe të jetë në funksion në sezonin e ngrohjes 2013/2014 me pjesën e ngrohjes qendrore. Pas zbatimit të këtij projekti, pritet të përgjysmohet kostoja e ngrohjes për qytetarë, si dhe do mundësohet zgjerimi i rrjetit në shumë pjesë të tjera të qytetit.

## 6. ZHVILLIMI DHE QËNDRUESHMËRIA URBANE

### 6.1. KORNIZA LIGJORE PËR PLANIFIKIM URBAN

Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor në Kosovë, në nivel lokal çdo komunë është e obliguar të posedon këto lloje të planeve hapësinore: Planin Zhvillimor i Komunës; Planin Zhvillimor Urban, dhe Planet Rregulluese Urbane. Komuna e Prishtinës është në përfundim të procesit për aprovimin e Planit Zhvillimor të Komunës 2013-2020+. Plani në fjalë përcakton orientimet zhvillimore urbane të KK të Prishtinës. Komuna i konsideron ato të jenë udhëzues për zhvillimin e Prishtinës deri në vitin 2020+. PZHU do të pësojë ndryshime në zhvillimet e mëtejme dhe do t'i përshtatet kërkesave ligjore aktuale. Duke rrespektuar PZHU të Prishtinës deri me sot për nevojat e KK janë aprovuar 12 Plane Rregulluese Urbane.

Me PZHK 2013-2020+ parashihet që Prishtina të zhvillohet në një qendër rajonale për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë së lartë informative – smart city. Në këtë drejtim do të trajtohet edhe krijimi i hapësirave urbane për zhvillimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të specializuara edhe nga kjo fushë.

Në komunën e Prishtinës përgjegjës për zhvillimin urban dhe hapësinor është Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUNMM). Kjo drejtori është e organizuar në pesë sektorë: Sektori i urbanizmit, Sektori i ndërtimit, Sektori për mbrojtje të mjedisit, Sektori i shërbimeve të përbashkëta dhe Sektori për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Kjo drejtori mestjerash është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik në nivel të komunës, duke qenë kompetente edhe për çdo aktivitet përcjellës në këtë drejtim.

### 6.2. TRAJTIMI I DISA ÇËSHTJEVE ME RËNDËSI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

**Shpërndarja hapësinore e ekonomive shërbyese** - Qyteti i Prishtinës është ballafaquar me nevojat shumë të mëdha dhe të theksuara për hapësirë dhe lokacione dhe shërbimeve komunale për strukturat qeveritare e jo qeveritare qendrore, institucioneve nderkombetare e deri te ato politike. Strategjia vijuese e qytetit duhet ti krijoj konceptet e reja parimore të zgjidhjese së problemeve dhe nevojave të qytetarëve për hapësirë banimi, aktivitete ekonomike dhe biznesore, jetë sociale, sportive e rekreative, hapësirë për aktiviteteve e institucioneve dhe organizatave të ndryshme që janë të vendosura në kryeqytet. Qeverisja komunale është duke krijuar kushte hapësinore dhe urbanistike për dislokimin e institucioneve qendrore në periferi të qytetit. Në veçanti duhet trajtuar nevojat për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe të bizneseve.

Është evidente mungesa e të dhënave zyrtare statistikore për këtë fushë tematike që zakonisht sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Cilësia e Regjistrimit

të fundit popullsisë është kontestuar nga shumë organizata të specializuara vendore dhe ndërkombëtare. Institucionet e specializuara të komunës kanë rezerva të mëdha lidhur me rezultatet e këtij regjistrimi, sidomos sa i përket numrit të banorëve.

Te gjitha keto janë probleme të cilat janë identifikuar edhe në strategjinë e kaluar, dhe të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje deri më sot, andaj vlen të identifikohen si të tilla pasi që edhe pengojnë realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të rëndësishme në kuadër të këtij departamenti e që kanë ndikim edhe në zhvillimin e komunes në pergjithësi.

**Banimi - Migrimi rural-urban:** Prishtina si qytet/komunë edhe më tutje vazhdon të ketë shkallën më të lartë të migrimit intern (ASK, 2012). Migrimi më i shprehur është në drejtim rural-urban, edhe pse është i pranishëm edhe ai urban-urban (nga qytetet e tjera të vendit për në Prishtinë). Intensiteti më i lartë i këtij migrimi është shënuar në vitet e pasluftës së vitit 1999. Kjo gjendje tani është stabilizuar pak a shumë, por nuk është ndërprerë. Sa i përket zhvillimit njerëzor, Prishtina klasifikohet si komuna me indeksin më të lartë të zhvillimit njerëzor (IZHNJ) prej 0,72%. Sipas ASK (2012) fenomeni i udhëtimit të rregullt vajtje/ardhje ndikon në rrjedhën e qarkullimit të automjeteve prandaj është me rëndësi për planifikimin dhe menaxhimin e transportit dhe për kontrollimin e trafikut rrugor. Prishtina si kryeqytet i Kosovës, qendër kryesore e punës dhe e arsimit, pret 56,000 persona që udhëtojnë çdo ditë. Kur merret parasysh numri real i njerëzve që janë shfrytëzues të shërbimeve publike të kryeqytetit është së paku dy fish më i madhe se numri zyrtar i banorëve të komunës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.

Çmimet e larta të tokës ndërtimore dhe banesave që arrijnë deri në 100,000 € për një ari në lagjet e urbanizuara dhe deri në 1,500 € - 2,500€ për m<sup>2</sup> të banesave në pjesën e qendrës së qytetit, nuk kanë ndikuar në rënjen e migrimit nga fshatrat apo qytetet tjera të Kosovës, por edhe jashtë. Lartësia e çmimit bie në drejtim qendër-periferi e qytetit. Në këtë kontekst, Komuna e Prishtinës ka marrë disa hapa për të zbutur këtë problem si përmirësimi i infrastrukturës, shërbimeve si dhe përkrahja e ekonomive familjare në zonat rurale si dhe avansimin në hartimin e planeve rregulluese për të lehtësuar ndërtimin e hapësirave të banimit.

## **NUMRI I BANORËVE SIPAS REGJISTRIMIT TË POPULLSISË 2011 DHE IMPLIKIMET NË ZHVILLIMIN E KOMUNËS**

Rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 të prezantuara pa ndonjë analizë të mirëfillt demografike kanë shkaktuar një konfuzion dhe paqartesi në trajtimin ekonomik, social, kulturor e demografik të qytetit të Prishtinës. Sipas projeksioneve të deritashme, numri i banorëve të Prishtinës duhet të jetë dukshëm më i madh me atë që ka dalë me regjistrimin e popullsisë të vitit 2011. Deri tash, të gjitha projeksionet e zhvillimit të Prishtinës janë bazuar në një numër më të madh të popullsisë, që sipas projeksioneve është llogaritur të jetë rreth 400,000 banorë, përderisa me regjistrimin e fundit të popullsisë thuhet se komuna e Prishtinës ka 198,897 banorë.

Si pasojë e kësaj mund të vie deri te zvogëlimi i kapacitetit buxhetor duke i zvogëluar percaktimet financiare të buxhetit për kryeqytetin e me këtë edhe të obligimeve, mundësive dhe detyrimeve të qytetit të Prishtinës karshi gati të gjitha sektoreve të shërbimeve dhe strukturave komunale. Prandaj, është e nevojshme që të rishqyrtohet kriteret dhe metodologjia për alokimin e granteve qeveritare në buxhetin e komunës duke i marrë parasysh specifikat e Prishtinës si kryeqytet, numrin real të banorëve, numrin real të shfrytëzuesve të shërbimeve publike në fushën e edukimit, të shëndetësisë dhe të shërbimeve tjera publike komunale.

## **PROBLEMET E QYTETIT TE PRISHTINES PER SHKAK TË LËVIZJEVE DEMOGRAFIKE**

Qyteti i prishtinës është ballafaquar me probleme të theksuara demografike si pasojë e tejzgjatjes së tranzicionit dhe të levizjeve demografike qysh nga paraluftra e posaqerisht pas luftes së vitit 1999. Prej asaj kohe e edhe në ditët e tanishme mungon një strategji për zgjidhjen e problemeve të krijuara. Nëse kesaj i shtohet një masë e madhe e levizjeve demografike në drejtim të emigrimit të një pjese të popullatës së qytetit, problemi i ndryshimeve demografike behet edhe me i theksuar. Edhe pse ndryshimet nuk mund të rikethehen, i mbetet strategjisë vijuese që të ketë kujdes dhe së paku ta amortizojë problemin e jostabilitetit demografik i cili së bashku me interpretimin joreal të numrit të banorëve të qytetit të Prishtinës dhe mungesën e statusit të kryeqytetit e bëjnë të ardhmen e Prishtinës me pasiguri dhe me pak mundësi për një zhvillim normal dhe me perspektivë për qytetarët e saj.

Nuk ka studime të veçanta që do të tregonin për strukturën dhe shtrirjen e kategorive të veçanta sociale të popullsisë në Prishtinë. Mund të thuhet se një koncentrim i qytetarëve me gjendje më të mirë materiale është në pjesë të urbanizuara të qytetit. Kjo, për arsye të kushteve më të mira për banim dhe afarizëm. Nga ana tjetër, nuk ka dukuri të lidhjeve të lagjeve me ndonjë grup specifik etnik apo religjioz. Në të gjitha pjesët e qytetit/komunës gjenden banorë të besimeve të ndryshme, të cilët jetojnë në një tolerancë fetare.

Lagjet periferike të qytetit/komunës po shënojnë një zhvillim të shpejtë gjë që tregon se këto pjesë po bëhen tërheqëse për të jetuar dhe përkundër çmimit të lartë të banimit në qendrën e qytetit. Këto zhvillime janë më shumë të aspektit ekonomik dhe të banimit (horizontal dhe vertikal). Jo gjithmonë këto zhvillime përcillen njëkohësisht edhe me zhvillim fizik (të infrastrukturës përcjellëse) dhe sipas planeve rregulluese të komunës.

## **KADASTRI KOMUNAL**

Sipas PZHU, Komuna e Prishtinës ka 42 zona kadastrale të shtrira në një sipërfaqe prej 523 km<sup>2</sup> dhe 58.849 njësi të banimit Drejtoria e kadastrës ka realizuar një zhvillim normal të menaxhimit të të dhenave si të atyre tekstuale ashtu edhe të atyre grafike. Komuna është pajisur edhe me disa elemente të sistemit GIS (Sistemi Informatik Gjeografik) dhe me metodat më bashkohore në domenin e menaxhimit kadastral. Komuna e Prishtinës, gjithsej ka inqizuar dhe perpunuar rreth 950 km kadastrë nëntokësor.

Eshte krijuar modeli digjital (GIS), matje 3D (x,y,z) për përçojat dhe objektet nëntokësore (të gjitha pusetat, objektet e inqizuara nëntokësore nëpër të cilat kalojnë përçojat). Mbledhja e informacioneve në terren është bërë në menyrë të drejtperdrejtë nëpër objekte nëntokësore duke përfshirë edhe matjet gjeodezike. Është bërë përpunimi i të gjitha informacioneve të mbledhura dhe sistemimi i tyre në modelin digjital dhe në atë analog. Kadastrin e Ndertesave (Regjistrimi i Kadastrit etazhor) është realizuar me mbështetjen financiare të Bankës Botërore gjatë periudhës 2010-2011. Me regjistrimin e banesave dhe lokaleve afariste qytetarëve iu është mundësuar që:

- Të sigurojnë pronën dhe pronësinë për ndertesën, banesën dhe lokalin e tyre afarist.
- Prona e tyre si e regjistruar behet objekt i sigurt i qarkullimit (shitblerjeve të dryshme).
- Prona e regjistruar mund të perdoret si kolateral për financimin e aktiviteteve ekonomike të tyre.
- Pajisen me çertifikata për pronësinë për të cilën garanton shteti-komuna.
- Fitimi i së drejte në bashkëpronësi në token në të cilën është ndërtuar ndertesa dhe në pjesët e perbashkëta të ndertesës si dhe mundësia për mirembajtjen e tyre etj.

Pas kësaj periudhe vazhdon regjistrimi i kadastrit të ndertesave në Drejtorië e kadastrit sipas kërkesave të qytetarëve ku deri i më tani janë regjistruar 507 njësi kadastrale.

**Rindërtimi i informacioneve kadastrale** - Gjate vitit 2010-2011 janë rindërtuar zonat kadastrale, si: Sofali, Kolovice, Shkabaj, projekt i financuar nga Banka Boterore dhe Bardhosh, Bernicë e Eperme, të financuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës. Poashtu, në periudhën 2011-2013 janë në përfundim e siper edhe zonat kadastrale Matiqan, Hajvali, Cagllavicë, Llukar, Lebanë dhe Trudë me bashkefinansim nga Banka Boterore dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës. Per Komunën e Prishtinës rindërtimi i informacioneve kadastrale është tejet i nevojshern për arsye të zhvillimeve shumë dinamike të ndodhura në kohë dhe mos azhurimi i titullarëve juridik të pronave për një peridhë të gjatë kohore.

Mund të nxjerrim si përfundim se Drejtoria e kadastrit i ka realizuar të shumtën e qellimeve dhe planeve të parapara me strategjinë e kaluar. Ka mbetur të vazhdojë në implementimin e teknologjive më të reja dhe aftesimin e stafit në perdorimin e kësaj teknologjie. Duke marrur parasysh fluktuimin e kuadrit procesi i trajnimit dhe aftesimit të stafit do të jetë i pandërprerë dhe afatgjatë. Një nga detyrat dhe qellimet vijuese të rëndesishme për Drejtorinë e kadastrit është krijimi i mundësive për profesionalizimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të drejtorisë. Në afatin sa më të shpejtë këto shërbime duhet të bëhen me internet duke e kursyer qytetarin nga pritjet e gjata gjatë realizimit të kërkesave të tij.

## 7. INFRASTRUKTURA LOKALE

Komuna e Prishtinës ka punuar mjaft në ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, ujërat atmosferike, ujësjellësit, ndriçimit publik, projekte këto të planifikuara edhe me strategjinë e kaluar dhe në pajtim me drejtoritë përkatëse drejt plotësimit të nevojave të qytetarëve por edhe bizneseve që veprojnë në komunë. Në Tabelën 7.1. janë paraqitur vëllimi fizik i mjeteve të investuar në infrastrukturës lokale, përgjatë viteve në komunën e Prishtinës.

**Tabela 7.1:** Projektet infrastrukturore 2008-2012

Vitet	Rrugë	Trotuare	Kanalizim	Ujësjellës	Vlera e përgjithshme e mjeteve të investuara
2008	49,66 km		36,74 km		7,747,187.00€
2009	41,98 km		23,43 km		11,040,892.17€
2010	62,29 km	126,035 m <sup>2</sup>	43,94 km	6,96 km	16,339,522.35€
2011	89,69 km	106,789.10 m <sup>2</sup>	51,85 km	12,64 km	20,265,231.73€
2012	35,91 km	17,506 m <sup>2</sup>	21,7 km	4,0 km	23,892,421.40€
<b>Gjithsej</b>	<b>279,53 km</b>	<b>250,330 m<sup>2</sup></b>	<b>177,66 km</b>	<b>23,60 km</b>	<b>79,285,254.65€</b>

Nga kjo analize e gjendjes shihet se përgjatë viteve është bërë një punë bukur e madhe sa i përket investimeve në infrastrukturën fizike, si rrugë, trotuare, ndriçim, ujësjellës si dhe kanalizime fekale, atmosferike dhe kabllovike. Mirëpo ende mbetet për tu bërë, duke u nisur nga fakti se popullsia e kryeqytetit në veçanti është në rritje dhe kërkesat e qytetarëve sa vijnë e shtohen. Në vitin 2012 vërehet se janë asfaltuar më pak kilometra rrugë sesa në 2011 edhe pse vlera e përgjithshme e mjeteve të investuara është më e madhe se në 2011. Kjo ka ndodhë për arsye se kemi të bëjmë me më shumë rrugë me dy korsi dhe me infrastrukturë përcejllese më të avansuar. Poashtu, në vitin 2012 një pjesë e buxhetit për infrastrukturë është bartur për vitin 2013 që don të thotë se vëllimi fizik i investimeve është shumë më i madh se sa ai i vitit 2011. E njehta gjë vlen edhe për kategoritë tjera si trotuare, kanalizim dhe ujsjellës.

## 8. ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI

Komuna e Prishtinës ka aprovuar Planin Zhvillimor të Arsimit për periudhë 2013-2017. Plani ka analizuar gjendjen në arsim, ka shtruar vizionin dhe objektivat strategjike dhe ka identifikuar nevojat buxhetore për mbështetjen e tij. Objektiva të këtij plani janë përcaktuar:

- Qeverisja dhe menaxhimi cilësor e efikas i institucioneve arsimore;
- Përfshirja e shtuar e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe ofrimi i shërbimeve cilësore;
- Ngritja e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsimin fillor dhe të mesëm;
- Ndërtimi i mekanizmave për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimeve dhe
- Krijimi i mjedisit miqësor, të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë.

Deri në fund të vitit 2017 me këtë plan kërkohet të sigurohet një buxhet prej 23,997,500.00 euro për të përmbushur nevojat e zhvillimit të arsimit në Prishtinë.

Mund të konstatohet se në vitet e fundit Komuna e Prishtinës ka arritur të zgjeroj rrjetin shkollor duke e bërë të mundur ngritjen e organizimit dhe funksionalizimin e sistemit arsimor në shkolla përmes përmirësimit të infrastrukturës me objekte dhe pajisje moderne shkollore si dhe ngritjes së cilësisë në procesin edukativo-arsimor.

Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë zhvillimore 2008-2012 janë bërë investime signifikante dhe të qëndrueshme në lëmin e ndërtimit të objekteve të reja shkollore duke mundur eliminimin e ndërrimit të tretë në shkolla, duke rritur hapësirën shkollore nga 0.86 m<sup>2</sup> për një nxënës në 1,77, që është afër përmbushjes së standardeve prej 1.8 deri 2.2 m<sup>2</sup> për një nxënës. Përmirësime të dukshme janë evidentuar edhe me renovime të shumta në objekteve shkollore, ndërtimin e terreneve sportive për aktivitetin e nxënësve në shkolla, përtëritjen e inventarit shkollor, didaktik, rregullimin e mjediseve të shkollave, sigurimin e hapësirave për aktivitete fizike dhe jashtëmësimore.

Struktura e arsimit para-universitar në komunën e Prishtinës është e organizuar në tri nivele: arsim parashkollor; arsim fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë. Komuna e Prishtinës ka gjithsejtë 54 institucione shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm në të cilat mësimin e vijnë 49,650 nxënës. Me këta nxënës punojnë 2,375 mësime.

Në edukimin parashkollor janë të përfshirë 1,939 fëmijë të sistemuar në 8 shkolla dhe një institucion parashkollor (IP) publiko-privat, me 51 paralele, aktivitetin e tyre e kryejnë në një hapësirë prej 11,442 m<sup>2</sup> ose 5.90 m<sup>2</sup> për fëmijë për të cilët përkujdesen 278 punonjës (199 prej personeli edukativ), 17 punëtorë administrativ

dhe 59 punëtorë ndihmës. Po ashtu, veprojnë edhe dyzet (40) institucione parashkollore private, prej tyre, vetëm 2 janë të licencuara, me 180 fëmijë prej 3-6 vjeç. Në institucione të tjera private janë sistemuar 1,393 fëmijë.

Përfshirja e nxënësve në arsimin e obliguar shënon shkallën afër 100%. Me këtë kategori punon afër 61% e personelit arsimor të komunës së Prishtinës, i cili është i kualifikuar për këtë nivel të edukimit. Në nivelin e arsimit fillor dhe i mesëm i ulët mësimin e vijnë 34,214 (17,721 djem dhe 16,493 vajza) nxënës me të cilët punojnë 1,754 arsimtarë, 113 punëtorë administrativë dhe 286 punëtorë ndihmës. Mësimi zhvillohet në 43 shkolla amë dhe 19 objekte shkollore si paralele të ndara. Në arsimin e obliguar mësimin e vijnë edhe 16 nxënës të nacionalitetit boshnjak dhe 94 nxënës të nacionalitetit turk. Aktivitetin edukativo-arsimor e kanë zhvilluar edhe 9 institucione arsimore private, me gjithsej 1,129 nxënës. Ky nivel i edukimit përfshinë 11,86% të nxënësve të këtij niveli në Republikën e Kosovës.

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë Komuna e Prishtinës ka 12 shkolla të mesme dhe një shkollë si paralele e ndarë në të cilat mësojnë 13,400 nxënës ku aktivitetin e tyre si mësimdhënës e zhvillojnë 719 arsimtarë , 36 punëtorë administrativë dhe 137 punëtorë ndihmës. Në arealin e Komunës funksionojnë edhe 9 shkolla të mesme private me 1,129 nxënës të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë në arsimin e mesëm. Komuna ka bërë përpjekje që rrjeti i shkollave fillore dhe të mesme të ulta të organizohet në atë mënyrë që nxënësit ta kenë shkollën sa më afër shtëpisë. Ndërtimi i lagjeve të reja paraqet nevojën për ndërtimin e shkollave të reja në ato lagje. Nga aspekti i pjesëmarrjes me numër të tënxënësve nga komuna e Prishtinës në nivel vendi është 12.12%, në çka ka ndikuar edhe trendi dinamik i migrimit në Prishtinë në periudhën pas vitit 1999. Përkundër investimeve në infrastrukturën shkollore, laboratorët dhe mjetet e konkretizimit mungojnë në shumicën e shkollave duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkolla.

Komuna ka treguar përkushtim në ngritjen e aktiviteteve të përbashkëta të shkollave, siq janë organizimi i garave të ndryshme të diturisë, aktivitete të ndryshme mësimore, kulturo-sportive, shënim i ngjarjeve të rëndësishme historike, kulturore dhe arsimore etj., si dhe është bërë monitorimi i procesit mësimor. Shumica e mësimdhënësve dhe personelit menaxherial të shkollave të komunës kanë ndjekur ndonjë formë të trajnimit .

Me gjithë investimet e bëra në infrastrukturë shkollore , me rreth 49,650 nxënës në arsimin para-universitar, klasat janë të mbingarkuara me nxënës, me 25 nxënës për klasë në arsimin fillor (që është për 16 % më shumë se standardi i lejuar prej 21 nxënës për klasë) dhe me 32 nxënës për klasë në nivelin e arsimit të lartë (që është për 52% më shumë se standardi i lejuar për klasë).

Institucionet private të arsimit para-universitar po kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë dhe kushteve në institucionet arsimore në komunë, në 3 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta mësimin e ndjekin 745 nxënës, ndërkaq në 4 shkolla të mesme të larta mësimin e vijnë 573 nxënës. Arsimi për fëmijët me aftësi të kufizuara,



në komunën e Prishtinës, zhvillohet në tri shkolla me 12 paralele në të cilat janë të përfshirë 115 nxënës. Përveç numrit dhe personelit arsimor në institucionet parashkollore, 212 edukatore, Komuna e Prishtinës ka 1754 mësimdhënës me orarë të plotë 43 institucionet në nivelin e arsimit fillor dhe i mesëm.

Komuna e Prishtinës gjeneron mjete të konsiderueshme nga të hyrat vetanake, mirëpo kufijtë buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave vazhdojnë të jenë pengesë, sidomos për rritjen e personelit mësimor, i cili sipas legjislationit në Kosovë mund të paguhet vetëm nga grantet buxhetore. Shkollat kanë një autonomi të kufizuar në menaxhimin e buxhetit e cila paraqitet si një pengesë për një menaxhim të mirëfilltë financiar. Siç është prezantuar në Tabelen 8.1. Komuna Prishtinës ka bërë investime të konsiderueshme në sektorin për arsim, kulturë, sport dhe rini duke ngritur përqindjen e investimeve kapitale në nivel Komunal.

**Tabela 8.1:** Investimeve kapitale për periudhën 2008-2012 në Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

N.R	Viti	Kulturë, Rini dhe Sport	Arsim dhe shkencë	Gjithsej Investime kapitale në kulturë, rini dhe sport dhe arsim dhe shkencë	% e pjesëmarrjes së investimeve kapitale në kulturë, rini dhe sport dhe arsim dhe shkencë në totalin e investimeve kapitale të komunës
1	2008	1,370,000.00	1,660,000	3,030,000.00	18.88
2	2009	650,000.00	2,470,000	3,120,000.00	19.44
3	2010	1,088,658.00	2,856,342	3,945,000.00	13.68
4	2011	2,393,000.00	4,063,157	6,456,157.00	20.73
5	2012	1,918,000.00	4,163,157	6,081,157.00	18.87

## KULTURA

Në Komunën e Prishtinës, kultura, sporti dhe rinia zënë vend të rëndësishëm. Në qytet janë të përqendruara objektet e rëndësishme të veçantë kulturore në nivel vendi si: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare, Bibliotekën e Qytetit "Hivzi Sylejmani", Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Muzeu i Prishtinës, Arkivi i Prishtinës, Shtëpitë e Kulturës, Qendra kulturore e fëmijëve, Radiot dhe Televizionet publike dhe private (RTK, TV21, TV Koha vizion, TV Klan Kosova) dhe media të shkruara, Filharmonia-Opera e Kosovës, Baleti i Kosovës, Festalet e Teatrove Ndërkombëtare në Prishtinë, Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, shoqëritë, grupet amatore të zhanreve të ndryshme muzikore, Festalet e muzikës serioze artistike në Prishtinë, Festalet e fëmijëve dhe Festalet e Filmave të ndryshëm artistikë. Të gjitha këto institucione kulturore dhe artistike, Prishtinës ia pasurojnë imazhin e kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Kryeqyteti ka Teatrin Kombëtar, teatrin Dodona si dhe teatrin ODA, etj. Kinematografia fillon me veprimtarinë e "Kosovafilmit" i cili u themelua në vitet '70 e cila ende gjendet në situatë të pavolitshme profesionale. Pos këtyre institucioneve në Prishtinë vepron edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve (ASHAK), Instituti i Historisë, Instituti Albanologjik, Arkivi i Kosovës, Arkivi i Qytetit, Muzeu i Kosovës, Galeria e Arteve dhe shumë institucione tjera me rëndësi.

Qyteti ka mjaftë monumente kulturore që vizitohen nga qytetarët e vendit, turistë të huaj, nga të punësuarit e përfaqësive diplomatike, misionet e ndryshme ndërkombëtare apo edhe delegacioneve shtetërore që vizitojnë shtetin e Kosovës, si: Monumenti i Skenderbeut, Nënë Tereze, Sahat Kulla, shtëpia e Emin Gjokës, Xhamia e Madhe, Xhamia e Qarshisë, Varri i ish Presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, Obilësken New Born, ish ndërtesa e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Katedralja „NënaTerezë“, Tyrbja e Sulltan Muratit, Gazimestani, Varrezat e Hebrejve, varrezat e Dëshmorëve etj. Në të ardhmen pritet që Prishtina të ketë vizita të shumta monumenteve, të sheshit Ibrahim Rugava dhe Zahir Pajaziti. Gjithashtu, hapësirat nëntokësore të Prishtinës ofrojnë mundësi të gjurmimeve arkeologjike të shënojnë periudhën e ilirëve që në të ardhmen mund të jenë mundësi potenciale për tërheqjen e vizitorëve.

Gjatë zbatimit të strategjisë së fundit Komuna e Prishtinës ka bërë një ngritje të dukshme në investime në fushën e trashigimisë kulturore të qytetit si: restaurimi i Hamamit të qytetit i ridestinuuar në Muzeun e Neolitit dhe Xhamisë së Qarshisë. Ky objekt, përveq hapsirës ekspozuese do të ketë edhe hapësira për galeri ku artistët mund të ekspozojnë punimet e tyre. Restaurimi i objekteve të kultit që kanë vlera historike duke i sjellur në gjendjen origjinale të ndërtimit, investimet në rritjen e fondit librar në bibliotekat e qytetit, ndërtimin dhe funksionalizimin e Arkivit të Prishtinës, modernizimin e Bibliotekës së qytetit si dhe investime tjera të rëndësishme për ruajtjen dhe ngritjen e kulturës autoktone të kësaj treve. Shtëpia e Hivzi Sulejmanit e rikonstruktuar duke e furnizuar me libra dhe inventar ka investuar në krijimin e amfiteatrit e cila do shërbejë si qendër multifunksionale për dashamirët e librit, krijuesit e rinj dhe ata shkollor.

Komuna e Prishtinës në vazhdimësi ka bashkëpunuar me teatrot private, shtëpitë filmike apo me shoqatat e kompozitorëve, muzicentëve dhe artistëve të tjerë figurativë dhe shkrimtarë duke u bërë një partner në afirmimin e vlerave kulturore vendore si para auditoriumit vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në sferën e muzikës janë përkrahur festivale në lëmi të ndryshme muzikore. Në lëminë e artit dhe kulturës janë përkrahur një mori festivalesh si: në film, teatër dhe dramë. Komuna me mjetet e veta përkrah aktivitetet kulturore si festivale të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, veprimtarinë botuese, ekspozita të ndryshme, promovime nga artet pamore dhe skenike, pjesëmarrjet e artistëve tanë, panairë të librit, panairë tradicionale, etj. Komuna ka përpiluar kalendarin kulturor i cili shërben si udhërefyës i aktiviteteve gjatë vitit si dhe ka bërë përkrahjen e projekteve në formë subvencioneve për aktivitetet gjinore.

Në Komunën e Prishtinës funksionon një numër i institucioneve dhe organizatave private në lëminë e artit, filmit, e teatrit si dhe muzikës serioze si: N.SH.Illirya Film, OJQ-“MonAkt, “Pri Film Fest”, teatri ODA, Skena Up, OJQ-Studio Filmi dhe Animacioni”, Fondacioni “ArsKosova” “Prishtina Jazz Festival, Qendra e Artit Muzikor “Dam”, etj. Në të ardhmën Komuna duhet bërë përpjekje në vazhdimin e këtij trendi pozitiv të projekteve investive në fushën e kulturës duke bashkëpunuar më shumë me donatorët potencial në ruajtjen e trashigimisë kulturore dhe shpirtërore të qytetit.

## RINIA DHE SPORTI

Duke u nisur nga fakti se Prishtina konsiderohet qytet i të rinjëve në këtë lëmi ka bërë investime të dukshme në përmisimin e terreneve sportive dhe të hapësirave rekreative. Funksionimi i klubeve sportive publike mbështetet në buxhetin komunal i cili është i pamjaftueshëm në krahasim me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit e ngritjes profesionale të këtyre klubeve. Komuna e Prishtinës ka një organizim të mirëfillt sportiv ku aktivitetin e tyre e kryejn 107 klube sportive në lëmi të ndryshme sportive, 13 prej tyre klube femrash.<sup>1</sup>

Pamundësia e pjesmarrjes së sportit në arenën ndërkombëtare ka bërë që në klubet sportive të bie motivimi për rezultate kulminante, megjithatë Komuna ka përkrahur ekipe dhe sportistë që kanë marrë pjesë në gara ndërkombëtare. Një përkrahje klubeve dhe ekipe sportive në Komunë është edhe lejimi i shfrytëzimit të sallave të edukatës fizike nga të njëjtat në shkolla me qëllim masovizimin e sportit të rinjët dhe nxënësit. Nga ana tjetër nuk ka një infrastrukturë ligjore stimuluese për biznese private të cilat do të donin të mbështesin sportin. Kjo gjendje është pasojë edhe e moskthimit të menaxhimit të Pallatit të Rinisë në kompetencë të Komunës, andaj ky objekt me potencial të madh të mbetet në mëshirën e kohës pa ndonjë investim që do ta bënte infrasrukturën e saj të shfrytëzueshme për aktivitete sportive dhe rinore.

Komuna e Prishtinës ka aprovuar „Planin e Veprimit Lokal Rinor 2013-2015”, si dhe 2 Rregullore për vullnetarizëm dhe Këshilli i Veprimit Rinor Lokal duke mundësuar jetësimin e politikave programore të Sektorit për Rini dhe Sport. Andaj përveq ngritjes së infrastrukturës sportive dhe rinore, komuna është e fokusuar edhe në ngritjen dhe avancimin e të rinjëve, sportistëve në fusha të ndryshme.

Me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve rinore Komuna ka bërë ndarjen e hapësirës për Qendrën Rinore të Prishtinës e cila mundëson realizmin e performancave të ndryshme rinore. Komuna ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme, ku janë mbështetur shumë aktivitete dhe projekte, me vlerë të konsiderueshme materiale. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të të rinjëve kryeqytetas janë mbështetur projekte të shumta. Në të njëjtën kohë janë organizuar ngjarje të rëndësishme rinore dhe sportive në: manifestime të ndryshme rinore, festivale, mbështetje

<sup>1</sup> Futboll, basketboll, hendboll, volejball,not, karate, pingpong, shah,atletikë, skitari, judo, mundje, boks, kick-box, aeroklub, taekëondo, bjeshkatari, fitness, bodibilding, aerobik, shenjëtari, çiklizëm, shoqata e pëllumbave sportiv,dhe peshkatari

të OJQ-ve rinore, mbështetje të artistëve në veprimtarinë e tyre, ekspozita dhe koncertet si dhe promovime, shfaqje, hulumtime, trajnime dhe filma. Kjo është realizuar duke përkrahur projekte të sportit (klubet sportive, shoqatat e ndryshme sportive si dhe avancimi i kuadrove në lëmin e sportit), dhe projektet e rinisë duke shënuar data të rëndësishme me aktivitete rinore-sportive siç janë: Maratona, Dita e Europes – 9 Maji, Dita e Prishtinës, Dita Ndërkombëtare e Rinisë, Muaji i Rinisë, Shpallja e Sportistit të Vitit etj.

## **9. SHËNDETI PUBLIK DHE MIRËQENIA SOCIALE**

Viteve të fundit Komuna e Prishtinës ka intensifikuar angazhimin dhe ka rritur numrin e projekteve për përmirësimin e përkujdesjes shëndetësore për qytetarët e Prishtinës. Përmirësimet në këtë sektor janë bërë duke filluar nga ndërtimi i qendrave të reja të mjekësisë familjare, furnizimi me pajisje të reja dhe moderne mjekësore për qendrat e mjekësisë familjare, furnizimi i rregullt me inventar, ngritja e kapacitetit të stafit etj. Ngjashëm, Komuna është angazhuar edhe në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhejn e çështjes së banimit për kategoritë vulnerable, ku për këtë qëllim janë ndërtuar 2 objekte banesore kolektive me gjithsejt 100 banesa, në lokacionin të "Fusha e Pajtimit", ndërkohë që për këtë vit është planifikuar ndërtimi edhe i 2 objekteve të tilla, njëra nga to tashmë ka filluar të ndërtohet. Megjithatë, duke marrë parasysh kompetencat e nivelit komunal për këta dy sektorë, e posaçërisht për mirëqenien sociale, duhet të thuhet që Komuna e Prishtinës i ka të limituara kompetencat ligjore dhe kapacitetet financiare për të ofruar mbështetje më të madhe sociale për qytetarët e saj.

Sfida kryesore në sektorin e shëndetësisë në komunën e Prishtinës mbetet mungesa e spitalit të qytetit si dhe kufizimet rreth rritjes së numrit të personelit shëndetësorë. Kujdesi shëndetësor në nivel vendi organizohet dhe zbatohet në 3 (tre)nivele:

- Parësor (Mjekësia Familjare)
- Dytësor (Spitali) dhe;
- Tretësor (QKUK – klinikat)

Mbrojtja primare (mjekësia familjare) është nën menaxhimin e komunave, përderisa Ministra e Shëndetësisë menaxhon mbrojtjen sekondare dhe terciare në Republikën e Kosovës. Në Prishtinë shërbimet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor ofrohen përmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancave (punkteve shëndetësore) të cilat janë nën menaxhimin e Komunës së Prishtinës; Kujdesi Dytësor dhe Tretësor është nën menaxhimin e qeverisë.

### **GJENDJA E SHËNDETËSISË**

Përparësitë më të mëdha të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në komunën e Prishtinës janë: kapacitetet profesionale (numri solid i specialistëve të mjekësisë

familjare – rreth 100) infrastruktura pothuasje e kompletuar e rrjetit të objekteve shëndetësore si dhe pajisja e mirë e tyre me pajisje mjekësore të nevojshme dhe moderne. Për më tepër, me përfundimin e ndërtimit të QMF IV (në muajin Qershor 2013), QMF në Fsh. Besi, Ambulancës në Fsh. Bardhosh dhe Barilevë që janë në fazën finale të ndërtimit, si dhe me ndërtimin a QMF në Lagjen e Muhaxherëve dhe Ambulancës së re në Fsh. Keqekollë të planifikuara për këtë vit, do të sigurohet një përkujdesje shëndetësore më cilësore dhe efektive për popullatën e komunës.

Nga faktorët e jashtëm, është me rëndësi të theksohet se shumica e rreziqeve lidhen me mungesën e Ligjit për Sigurime Shëndetësore, furnizimi i pamjaftueshëm me barëna dhe material tjetër shpenzues mjekësor nga ana e MSH, kompetencat e limituara të Komunës për menaxhimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, mungesën e Sistemit të Informimit Shëndetësor (edhe pse tashmë ka filluar implementimi i tij nga ana e MSH, ku Komuna e Prishtinës është përfshirë në pilot projekt), kufizimet në rekrutimin e stafit të ri si në sektorin e shëndetësisë ashtu edhe në atë të mirëqenies sociale; kështu, ndërtimi i objekteve të reja kushtëzohet në rekrutim të stafit, posaçërisht për ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale (p.sh. shtëpisë së pëlqeve apo shërbimet për grupet e marginalizuara).

Komuna e Prishtinës ka arritur të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, ndëkohë që nga viti 2012, në bashkëpunim OBSH është duke u implementuar projekti për për zbatimin dhe monitorimin e standardeve për rritjen e shëndoshë të fëmijëve të moshës 0-5 vjeç ka vazhduar në të gjitha QMF ku roli i mjekut familjar në këtë drejtim po vie gjithnjë e më shumë në shprehje; Përkundër sfidave, komuna mbetet e vendosur dhe bën përkjekje të vazhdueshme që të arrihet praktikimi i standardeve të përcaktuara nga OBSH. Mundësia tjetër lidhet me shfrytëzimin e donacioneve për përmirësimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Komuna veç se është angazhuar në të kaluarën në projekte të tilla, mirëpo shfrytëzimi i donacioneve duhet të vazhdojë, të intensifikohet posaçërisht në zhvillimin e mirëqenies sociale dhe kur kemi parasysh faktin se në Prishtinë ka shumë vizita për qëllime shëndetësore edhe nga popullësia e komunave tjera.

## **MBROJTJA PRIMARE - MJEKËSIA FAMILJARE**

Shërbimet shëndetësore të mbrojtjes primare për qytetarët e komunës së Prishtinës ofrohen përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, 14 Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe 15 Ambulancave Shëndetësore në pjesët rurale. Në kuadër të QKMF ekziston si njësi e veçantë e organizimit edhe Poliklinika e Stomatologjisë dhe 16 ordianca stomatologjike në 13 QMF të cilat ofrojnë shërbime stomatologjike. Prishtina ka edhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente përmes së cilës ofrohen shërbime të urgjencës paraspitalore.

Sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministra e Shëndetësisë (të cilat burojnë nga OBSH-ja), për çdo 10 mijë banorë duhet të jetë në funksion një Qendër e Mjekësisë Familjare në Republikën e Kosovës. Sipas të dhënave të fundit të regjistrimit të

popullsisë së vitit 2011, Prishtina numëron rreth 200 mijë banorë. Por, siç kemi diskutuar më herët në këtë strategji, vlerësohet se ky numër mund të jetë edhe më i madh duke pasur parasysh migrimet e mëdha nga qytetet dhe fshatrat tjera në Prishtinë, banorët e të cilëve mund të jenë regjistruar në komuna tjera por që jetojnë dhe veprojnë në Prishtinë. Edhe numri i shërbimeve shëndetësore të ofruara gjatë vitti 2012 në kuadër të Kujdesit Parësor në Komunën e Prishtinës është shumë më i madh se mesatarja e shërbimeve shëndetësore të përcaktuara në nivel vendi; kështu gjatë vitit 2012 numri i vizitave shëndetësore është rreth 810.000, apo 4.1 vizita për kokë banori (në nivel vendi 2.5 vizita për kokë banori), rreth 1.1 milion shërbime tjera shëndetësore, apo 5.5/për kokë banori (kundrejt 3.5/për kokë banori në nivel vendi)

Kriteret e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë specifikojnë që për çdo 2,500 qytetarë të Republikës së Kosovës duhet të jetë në shërbim një specialist i mjekësisë familjare si dhe dy infermierë. Kjo nënkupton që çdo qendër e mjekësisë familjare duhet të plotësojë kriterin e numrit minimal të pacientëve (banorëve të lagjes ku operon), dhe rrjedhimisht çdo mjek duhet të ketë listën e pacientëve të tij. Ky sistem mundëson ofrimin e shërbimeve shëndetësore më cilësore sepse çdo mjek do të ketë mundësi që të monitorojë pacientët e tij.

Aktualisht, në Komunën e Prishtinës shërbimet e mjekësisë familjare ofrohen nga 138 mjekë, prej tyre 96 specialistë të mjekësisë familjare dhe 42 mjekë të përgjithshëm; shërbime konsultative specialistike ofrojnë 63 specialistë të lëmive tjera, prej tyre: 21 pediatria, 8 gjinekologë, 7 dermatovenerologë, 6 specialistë të mjekësisë së punës, 3 biokimistë, 3 radiologë, 3 internista, 2 pneumofiziologë, dhe nga 1 specialistë të fushave përkatëse: epidemiologë, higjienës, ORL, reumatolog, oftalmolog dhe 1 sociologe. Numri i stafit me kualifikim të mesëm shëndetësor (infermierë të përgjithshëm, laborantë, teknik të radiologjisë) është 380. Në shërbimin e stomatologjisë shërbime profesionale stomatologjike ofrojnë 44 stomatologë dhe 61 asistentë/teknik të stomatologjisë.

Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë të punësuar 21 mjekë, prej tyre 2 specialistë të urgjencës, 2 internista, 6 specialistë të mjekësisë familjare dhe 11 mjekë të përgjithshëm; numri i infermierëve është 38. Shërbimet profesionale shëndetësore mbështeten edhe nga 105 punëtorë jo-shëndetësor dhe të administratës. Është e rëndësishme të theksohet, që Komuna e Prishtinës është shumë e kufizuar sipas kompetencave të përcaktuar me ligj që të punësoje personel të ri shëndetësor me çka kufizohet edhe mundësia e rritjes së kapaciteteve për të ofruar shërbime shëndetësore.

Tabela 9.1 ofron detaje rreth numrit dhe personelit shëndetësorë të Kujdesit Parësor Shëndetësor (Mjekësisë Familjare dhe Qendrës së Mjekësisë Urgjente)

**Tabela 9.1. Struktura e Personelit Shëndetësorë në Mjekësinë Familjare dhe në Qendrën e Mjekësisë Urgjente, 2013**

<b>Struktura e personelit shëndetësorë në Mjekësinë Familjare</b>	<b>Nr i personelit</b>
Specialistë të mjekësisë familjare	96
Mjek të përgjithshëm	42
Specialistë të lëmive tjera*	59
Me kualifikim të mesëm (infermierë, teknikë laborantë, teknikë rentgeni, teknik farmacist, etj.)	380
Stomatologë	44
Asistentë / teknikë të stomatologjisë	61
Punëtorë joshëndetësorë dhe të administratës	77
<b>Struktura e personelit shëndetësorë në Qendrën e Mjekësisë Urgjente</b>	
Specialistë të Urgjencës	2
Internistë	2
Specialistë të mjekësisë familjare	6
Mjekë të përgjithshëm	11
Me kualifikim të mesëm (infermierë, laborantë)	38
Shoferë	12
Punëtorë joshëndetësorë dhe të administratës	16

\* *Specialistë pediatria, Gjinekologë, Dermatovenerologe, Specialistë të mjekësisë së punës, Biokimistë, Radiologë, Internistë, Pneumofitziologë, ORL, Oftalmolog, Epidemiolog, Reumatolog, Specialist i Higjienës, Sociolog.*

## **MBROJTJA SEKONDARE DHE TERCIARE**

Mbrojtja sekondare dhe terciare Mbrojtja sekondare dhe terciare bie nën kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë sipas ligjeve në Republikën e Kosovës. Prandaj, Komuna e Prishtinës nuk ka kompetenca në mbrojtjen sekondare dhe terciare. Në përgjithësi, shërbimet shëndetësore në kuadër të nivelit sekondar dhe terciar ofrohen nga klinikat e specializuara pasi që Prishtinës i mungon spitali i përgjithshëm. Qendra Klinike Universitare e Kosovës është institucioni kryesor shëndetësor në tërë vendin. Aktualisht nën ombrellën e QKUK-së operojnë 27 klinika. Gjithashtu, në kuadër të QKUK-së operojnë edhe 8 institutet e Fakultetit të Mjekësisë.

## MIRËQENIA SOCIALE

Me decentralizimin e shërbimeve sociale në vitin 2009, Komunat kanë marrë përgjegjësi të theksuara për sa u përket ofrimit të shërbimeve sociale në territorin e tyre; megjithatë ky decentralizim nuk është shoqëruar edhe me implikimet buxhetore për këto shërbime, prandaj komunat po ballafaqohen me sfida serioze në gjetjen e burimeve financiare për të ofruar shërbime cilësore sociale. Në Komunën e Prishtinës, shërbimet sociale ofrohen përmes 3 njësive të QPS (Njësia në Qafë, Kodrën e Trimave dhe Bregun e Diellit) me gjithsej 49 zyrtarë të punësuar. Çështja e banimit të grupeve vulnere ka qenë njëra ndër fushat kryesore të adresimit social të Komunës gjatë 3-4 viteve të fundit. Kështu, gjatë viti 2011 dhe 2012 janë ndërtuar 2 objekte banesore kolektive me gjithsej 100 banesa të "Fusha e Pajtimit"; 50 prej tyre dedikuar për familjet në asistencë sociale dhe 50 për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së.

Për vitin 2013 është planifikuar ndërtimi edhe i 2 objekteve banesore kolektive me nga 50 banesa secila prej tyre, pra gjithsej 100 banesa; Objekti i parë dedikuar për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së tashmë ka filluar të ndërtohet, ndërkohë që objekti i dytë dedikuar për familjet në asistencë sociale pritet të fillojë së shpjeti.

Mbështetja financiare familjeve skamnore, qoftë për sigurimin e ushqimit, blerjen e barëneve apo nevoja tjera, si dhe përkrahja e OJQ për aktivitete sociale në fushën e personave me aftësi të kufizuara, si dhe grupet tjera vulnere të popullatës, është një fushë tjetër ku Komuna e Prishtinës për çdo vit siguron përkrahje direkte përmes subvencioneve.

## 10. VLERËSIMI I AFTËSIVE KONKURRUESE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS (ANALIZA SWOT)

Tabela 10.1 pasqyron rezultatet e analizës SWOT e cila identifikon pozicionin konkurrues të Komunës së Prishtinës në raport me komunat tjera të Kosovës dhe qendrat e mëdha në rajon. Kjo analizë ka shërbyer si bazë për identifikimin e synimeve dhe objektivave për të jetësuar vizonin e Prishtinës.



**Tabela 10.1: Vlerësimi i aftësive konkurruese të Komunës së Prishtinës- Analiza SWOT**

FAKTORËT	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
<b>POZITIVË</b>	<p><b>Përparësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pozita e kryeqytetit me koncentrim të bizneseve, institucioneve administrative, arsimore, shëndetësore, shërbimeve financiare, kulturore dhe sportive kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>Koncentrimi i resurseve njerëzore dhe kapaciteteve intelektuale</li> <li>Buxheti në rritje i komunës</li> <li>Ekzistimi i planit zhvillimor komunal dhe planit zhvillimor urban dhe disa strategjive sektoriale</li> <li>Stafi profesional i Komunës</li> <li>Prodhimi i ushqimeve organike</li> <li>Shërbimet efektive për qytetarët</li> <li>Mbulimi i plotë me shërbime primare shëndetësore</li> <li>Infrastruktura e ndërtuar në pjesët urbane dhe rurale</li> <li>Numri i madh i klubeve sportive për sporte të ndryshme</li> </ul>	<p><b>Mundësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Prezenca e organizatave ndërkombëtare financiare dhe fondacioneve të ndryshme në komune dhe mundësia që kryeqyteti të përfitoj nga asistencë financiare dhe teknike nga BE dhe donatorë të jashtëm</li> <li>Potenciali i investimeve të jashtme dhe të diasporës</li> <li>Afërsia e korridoreve të trafikut ndërkombëtar</li> <li>Proceset integruese rajonale dhe Europiane</li> <li>Koordinimi me akterët qëndror dhe akterët tjerë</li> <li>Partneriteti publiko-privat</li> <li>Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe digjitalizimi i arsimit dhe shëndetësisë</li> <li>Bartja e kompetencave për shërbimet publike</li> </ul>
<b>NEGATIVË</b>	<p><b>Dobësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e një sistemi të integruar të të dhënave statistikore</li> <li>Infrastruktura e pamjaftueshme për zhvillimin e NVM-ve (parqet e biznesit dhe inkubatorët)</li> <li>Fermat e vogla dhe të parcializuara dhe kapacitete e pamjaftueshme përpunuese</li> <li>Ndërtimet ilegale ende prezente</li> <li>Disa zona ende të pambuluara me plane rregulluese</li> <li>Menaxhimi jo i kënaqshëm i hapësirave publike (parkingje, persona me aftësi të kufizuara, garazha, hapësira gjelbëruese, shtigjet e biçiklistave)</li> <li>Vetëdijesimi i pamjaftueshëm i qytetarëve për ruajtjen e ambientit</li> <li>Transporti publik i paintegruar</li> <li>Niveli i pamjaftueshëm i turizmit kulturor, rural, kongresist, sportiv</li> </ul>	<p><b>Rreziqet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vonesa e mëtejme e nxjerrjes së Ligjit për Kryeqytetin</li> <li>Komunikimi i vështirësuar me pushtetin qëndror lidhur me përkrahjen e projekteve të mëdha investive</li> <li>Ndikimi negativ në mjedis nga termocentralet ekzistuese dhe ato që planifikohen të ndërtohen</li> <li>Mospërputhja e gjendjes faktike të popullsisë me regjistrimin e fundit dhe zvogëlimi i grantit qeveritar</li> <li>Ekonomia jo-formale</li> <li>Degradimi i tokës bujqësore dhe pyjeve</li> <li>Mungesa e fondeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore</li> <li>Pamundësia e menaxhimit të aseteve komunale (AKP-ja dhe uzurpimet e pronave)</li> <li>Çmimet e larta të tokës dhe mungesa e buxhetit për shpronësime të tokave për interes publik</li> <li>Mungesa e dokumentacionit kadstral origjinal</li> <li>Mungesa e spitalit të qytetit</li> </ul>

## 11. VIZIONI

### Vizioni i Komunës së Prishtinës:

**Prishtina kryeqytet i Kosovës, qytet metropolitan me tipare evropiane, e njohur për zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime publike efikase e cilësore, e integruar në zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale e financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.**

## 12. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

Vizioni i Komunës së Prishtinës është përcaktim i vullnetit dhe ambicieve të qytetarëve të Prishtinës dhe të Kosovës që Kryeqytetin e Republikës së Kosovës në një të ardhme të afërt ta shohin si qytet metropolitan me tipare evropiane. Në këtë pikë duhet të jetë kthesa kryesore dhe përqendrimi në zbatimin e zhvillimit strategjik të kryeqytetit. Rezultatet e arritura deri tani në shumë fusha paraqesin mundësi për të bërë hapin e nevojshëm të radhës për të bërë Prishtinën një Kryeqytet Evropian dhe qendër metropolitan me rëndësi jo vetëm për Kosovën por edhe për rajonin. Institucionet komunale dhe ato qendrore e kanë për obligim që në një afat sa më të shkurtër të krijojnë kornizën e nevojshme institucionale, ligjore dhe strukturale që Prishtina pa pengesa ta realizojë këtë rol. E tërë kjo, Prishtinën si Kryeqytet të Republikës së Kosovës do ta bënte gjithnjë e më atraktive për të jetuar dhe zhvilluar aktivitetet e tyre ekonomike, kulturore dhe sportive si dhe që kryeqyteti të tyre për këto cilësi të bëhet pikë referimi në rajon dhe më gjerë.

Institucionet e komunës dhe akterët e interesit në nivel lokal dhe qendror duhet të përqendrohen që me prioritet t'i realizojnë ato synime dhe objektiva të kësaj strategjie dhe të Planit Zhvillimor të komunës, që në mënyrë të dukshme i përmbushin orientimet kryesore të vizionit të komunës që Prishtina të bëhet qytet metropolitan dhe një kryeqytet me tipare evropiane. Në këtë drejtim, gjatë periudhës së kaluar strategjike, janë realizuar disa projekte të rëndësishme në përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës urbane dhe publike, rregullimi i qendrës dhe shesheve të kryeqytetit, ndërtimi i unazave të brendshme rrugore, rrethqarkullimet, zgjerimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta dhe parqeve.

Për t'i realizuar me sukses synimet dhe objektivat e kësaj strategjie nevojitet angazhim i plotë i institucioneve të komunës, akterëve të interesit dhe vullnet i institucioneve të nivelit qendror në tejkalimin e disa dobësive dhe pengesave të natyrave të ndryshme që janë identifikuar edhe në analizën SWOT të kësaj strategjie zhvillimore.

Mungesa e Ligjit mbi kryeqytetin është ndër pengesat më madhore që Prishtina të zhvillohet më shpejtë në një Kryeqytet modern me tipare mtropolitane

dhe europiane, prandaj duhet të shfrytëzohen të gjitha mundësitë politike, institucionale dhe lobuese që ky ligj të aprovohet sa më shpejtë. Pasojat e mos njohjes me ligj të statusit të kryeqytetit po reflektohen negativisht edhe në funksionimin e Prishtinës si Kryeqytet, në mungesa buxhetore sidomos për investime kapitale, zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe publike dhe shërbime më cilësore për qytetarë dhe biznese. Prishtina si Kryeqytet me tipare European dhe Metropolitan synon që buxheti të vazhdojë trendin e rritjes edhe me tutje nga të ardhurat vetiake dhe nga buxheti qendror.

Perfundimi i planeve rregulluese dhe zabtimi i tyre me investime në infrastrukturë publike – rrugët trotuare, banim, parkingje me fondet e buxhetit të Prishtinës, iniciative private dhe PPP duhet të zgjerohet dhe vazhdojë trendin e deritashem pozitiv. Ndërtimet ilegale dhe uzurbimi i pronës publike janë identifikuar si ndër dobësit kryesore dhe këtu nevojiten masa edhe me rigorozë. Me këtë strategji janë identifikuar disa objektiva dhe projekte që ndërtimet ilegale të zvogëlohen në maksimum, ndër të tjera edhe duke e zvogëluar kohën e zgjidhjes së kërkesave për leje ndërtimi dhe legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje.

Integrimi i transportit urban është i ndërlidhur me këtë poashtu. Qytetarëve të Prishtinës duhet tu mundësohet lëvizja dhe tarrsporti më i lehtë dhe më i rehatshem.

Prishtina Metropolitanë kërkon udhëheqjen e një marketingu urban që të sillte sa më shumë investime private dhe publike në zhvillimin e bizneseve, arsimin, shëndetësisë, shërbimeve intelektuale, financiare dhe të teknologjisë informatike.

Për të ndërtuar rolin e një qendre me tipare europiane e rajonale Prishtina duhet gjithashtu të zhvillojë kapacitetet e saj për turizmin kongresial, turizmin kulturor, të sigurojë shumë më shumë ngjarje si tubime me rëndësi politike dhe ekonomike, ngjarje kulturore, sportive dhe të tjera të karakterit rajonal, european e global. Kjo kërkon krijimin e një zyre të posaçme të marketingut dhe promovimit të Prishtinës në këto rrafshë.

Bazuar në analizën e gjendjes dhe në vizionin për të ardhmen e Prishtinës, më poshtë janë identifikuar synimet dhe objektivat.

### **Synimi 1. Prishtina kryeqytet me tipare metropolitane dhe europiane**

S1O1. Deri në fund të vitit 2015 të krijohet korniza e nevojshme institucionale që Prishtina ti kryejë pa pengesa funksionet e kryeqytetit;

S1O2. Zhvillimi i projekteve me rëndësi për kryeqytetin dhe komunat e tjera: deri në vitin 2016 sigurimi i ujit të pijshëm për furnizim 24 orësh për gjithë qytetarët e Prishtinës dhe ekonominë; sigurimi i ngrohjes përmes sistemit të kogjenerimit, shënim progresi në programet me PPP dhe fillimi i projekteve të përbashkëta për pastrimin e ujërave të zeza dhe reciklimin e mbeturinave.

S103. Modernizimi i transportit publik me infrastrukturë adekuate dhe moderne duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë shërbimeve me qëllim të përmirimit të jetës së banorëve dhe zhvillimin e bizneseve.

S104. Promovimi i Prishtinës si qendër rajonale nëpërmjet organizimit të ngjarjeve të rëndësishme biznesore, kulturore, sportive, rinore, kongresiste me karakter rajonal dhe ndërkombëtar.

S105. Do të krijohen kushtet e nevojshme teknike e institucionale në mënyrë që Prishtina të fiton primatin e një qendreje rajonale të njohur për ofrimin e shërbimeve cilësore nëpërmjet teknologjisë së lartë informatike – smart city.

S106. Deri në vitin 2016 të modernizohet transporti publikë me infrastrukturë të nevojshme për fillimin e menaxhimit të integruar të transportit publik të udhëtarëve.

## **Synimi 2. Krijimi i një mjedisi më të favorshëm për zhvillim të bizneseve**

S201. Rritja e numrit të bizneseve në Komunën e Prishtinës deri në vitin 2016

S202. Deri në fund të vitit 2016 realizmi i projekteve me PPP në vlerë së paku 50 milion euro

S203. Deri në fund të vitit 2016 përkrahja e 3000 bizneseve fillestare nëpërmjet këshillimit, trajnimit, subvencionimit të bizneseve të reja

S204. Përfshirja e së paku 500 të rinjëve në programe të trajnimit, bursave dhe intershipit çdo vit.

## **Synimi 3. Avansimi i kapaciteteve institucionale dhe fizike për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve**

S301. Rritja e qëndrueshmërisë së të hyrave vetanake dhe përcaktimi i kriterëve objektive për financimin e Prishtinës nga grantet qeveritare

S302. Deri në fund të vitit 2016 së paku 50% e stafit të angazhuar në ofrimin e shërbimeve ndaj bizneseve të përfshihen në programe të avancimit profesional.

S303. Krijimi i parqeve të biznesit dhe zonave industriale si dhe ofrimi i shërbimeve kontraktuale komunale në zonat biznesore

S304. Deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2014 funksionalizimi i zyrës për shërbime të shpejta të biznesit (one-stop shop) dhe zyrës për promovim të investimeve

#### **Synimi 4. Rritja më e shpejt e zhvillimit të qëndrueshëm rural**

S4O1. Përfshirja fermerëve në programet për aplikimin e teknikave bashkëkohore në prodhimtarinë bujqësore.

S4O2. Rritja e sipërfaqeve të ujtura.

S4.O3. Zhvillimi i turizmit rural dhe prodhimatarisë bujqësore

#### **Synimi 5. Zhvillimi i qëndrueshëm urban, hapsinor dhe mbrojtja e mjedisit**

S5O1. Deri në fund të vitit 2014 të përfundohen të gjitha planet rregulluese për zonën urbane

S5O2. Arritja e standardeve europiane për hapësirat e gjelbruara duke i rritur sipërfaqet të gjelbëruara për 20% në vit, duke aplikuar energjinë e ripërtitshme, kursimin e energjisë dhe menaxhimin e mbeturineve

S5O3. Trajtimi i të gjitha objekteve të ndërtuara pa leje dhe legalizimi i tyre sipas ligjeve në fuqi S5O4. Kompletimi i infrastrukturës primare në qytet dhe fshatra dhe ndërtimi i korridoreve kryesore ndërlidhëse të pjesëve urbane dhe rurale dhe lidhja e të gjitha vendbanimeve me kryeqytetin

S5O5. Ngritja e efikasitetit në lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe nxitje e zhvillimi të sektorit të ndërtimitarisë

#### **Synimi 6: Përmirësimi i shërbimeve publike në përputhje me tiparet e një qyteti europianis**

S6O1: Zgjidhja e problemit për mbledhjen e mbeturinave nga ndertimet dhe rrënimet e objekteve, si dhe rritja e efikasitetit për hedhjen dhe mbledhjen mbeturinave në amvisëri në tërë territorin e komunës.

S6O2: Mbulimi i të gjitha zonave urbane, urbano-periferike dhe rurale në mirëmbajtjen e rrugëve.

S6O3: Deri në fund të vitit 2016, të bëhet rregullimi, rigjenerimi i hapësirave gjelbëruese të qytetit për 80%.

### **Synim 7. Ngritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve arsimore me infrastrukturë të mjaftueshme dhe funksionale, gjithpërfshirje, barazi dhe respektim të diversitetit në arsim**

S7O1: Deri në fund të vitit 2015 eliminimi i ndrrimit të dytë në 30% të shkollave filllore dhe të mesme, ndërsa 80% deri në fund të vitit 2016.

S7O2: Përfshirja e së paku 10% të mësimeve në aktivitet trajnuese për zhvillimin e vazhdueshëm profesional çdo vit;

S7O3: Deri në vitin 2015 do të arrihet përfshirja në arsimin e obligueshëm të gjitha grup-moshave, etnive 100%. Se paku 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshihen në arsimin e obliguar.

S7O4 Deri në vitin 2014 së paku 85% e shkollave të jenë të pajisura me infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore.

### **Synimi 8. Rritja e cilësisë dhe numrit të ngjarjeve kulturore dhe sportive me infrastrukturë adekuate institucionale, teknike dhe profesionale**

S8O1. Përfshirja e të gjitha objekteve me rëndësi të trashigimisë ndër shekuj në programin për ruajtjen dhe konzervimin e tyre deri më 2015.

S8O2. Rritja për 40% e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve kulturore deri në fund të vitit 2016.

S8O3. Rritja për 70% e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve sportive deri në fund të vitit 2016.

### **Synimi 9. Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirqenies sociale**

S9O1: Kompletimi i infrastrukturës shëndetësore deri në vitin 2016 që plotësojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të mjaftueshme

S9O2: Deri në vitin 2015 instalimi i sistemit adekuat të informimit në të gjitha objektet e Mjekësisë Familjare.

S9O3: Deri në fund të vitit 2016 në së paku 50% të QMF-ve të ofrohen shërbime konform standardeve të përcaktuara nga OBSH për mjekësinë familjare.

S9O4: Deri në vitin 2016 sigurimi i kushteve të banimit për së paku 300 familje në nevojë, 150 banesa për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së dhe 150 për familjet në asistencë sociale.

### **13. PROJEKTET PËR ARRITJEN E SYNIMEVE DHE OBJEKTIVAVE**

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet që sigurojnë arritjen e synimeve dhe objektivave të paraqitura më lart. Kjo listë prej 230 projektesh, nuk është përfundimtare, por është vetëm listë e projekteve të identifikuar, që shërbejnë për orientim të zhvillimit të aktiviteteve të Komunës së Prishtinës. Kësaj liste mund t'i shtohen edhe projekte të tjera që mund të identifikohen në vazhdimësi. Në tabelë paraqitet edhe kostoja e secilit projekt. Kostoja totale për të gjitha projektet e identifikuar është **266.503.246€**.

Për secilin projekt janë identifikuar partnerët implementues të mundshëm dhe afati i realizimit nga momenti i fillimit të projektit.

Në kolonën e pestë janë identifikuar projektet që potencialisht mund të realizohen me koncesion, përmes partneritetit publik-privat ose huazimeve ndësa në kolonën e gjashtë është kostoja e këtyre projekteve që është në vlerë prej **42,700,000€** (e cila nuk përfshihet brenda koston totale të strategjisë). Investimet private në ndërtimtari parashihet të jenë mbi **1,200,500,000.00 €**.

Nr.	Plani i implementimit	Kostoja totale në €	Partnerët implementues	Afati orientues kohor	Realizimi përmes koncesioneve/partneriteti publik-privat/huazimit (në €)	Investimet private (në €)
	[1]	[2]	[3]	[4]	[5]	[6]
<b>Synimi 1. Prishtina kryeqytet me tipare metropolitane dhe europiane</b>						
1	Rekonstruktimi i rrjetit të ujit në të gjitha lagjet e Prishtinës	25.000.000	Komisioni Europian, Qeveria e Kosovës, Kfw dhe Komuna e Prishtinës	2016		
2	Ndërtimi i Fabrikës së Re të ujit me kapacitet 500 litra në sekond	35.000.000	Komisioni Europian, Qeveria e Kosovës, KfW dhe Komuna e Prishtinës	2016		
3	Projekti i kogjenerimit	30.000.000	Komisioni Europian, KfW dhe Komuna e Prishtinës, Qeveria e Luksemburgut, SIDA suedeze	2015		
4	Furnizimi me 50 autobusë të rinj për trafikun urban	7.500.000	Komuna e Prishtinës dhe donator të jashtëm	4 vite		
5	Përgatitjet për realizimin e projektit hekurdhor sipas projektit PZHU	300.000	Komuna dhe qeveria	2 vite		
6	Përgatitja e projektit për pastrimin e ujrave të zeza në bashkëpunim me komunat përreth	2.000.000	Komuna e Prishtinës, Qeveria dhe komunat fqinje	4 vite		



7	Përgaditja e projektit për rreckillimin e mbeturinave	1,000.000	Komisioni Europian, Qeveria, Komuna	4 vite	
8	Ndërtimi i garazhit nëntokësor pas hotelit Grand		PPP	2 vite	4.000.000,00
9	Ndërtimi i dy garazheve nëntokësore në lokacionet qëndrore		PPP	4 vite	16.000.000,00
10	Ndërtimi i dy nënkalimeve me qendra të biznesit		PPP	2 vite	4.000.000,00
11	Stadioni i futbollit i standardeve të FIFA-s		PPP	4 vite	15.000.000,00
12	Organizimi i ngjarjeve kulturore me karakter rajonal dhe nderkombëtar	150.000	Komuna	4 vite	
13	Projekti për korridorin e tramvajit për Prishtinën e Re		Komuna/ppp	2015	200.000,00
14	Organizimi i aktiviteteve rinorore, sportive dhe kongresiste me karakter rajonal dhe nderkombëtare	180.000	Komuna	4 vite	
15	Projekti për përkrahjen e Teknologjisë së avancuar - Smart City	300.000	Komuna	2 vite	
16	Menaxhimi integruar i transportit publik	50.000	Komuna, PPP	3 vite	
<b>Vlera e projekteve per Synimin e parë</b>		<b>101.480.000</b>			<b>39.200.000</b>

Synimi 2. Krijimi i një mjedisi më të favorshëm për zhvillim të bizneseve							
17	Përrfundimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2013-2016	59.500	Komuna	2013			
18	Tryeza debatuese e bizneseve	20.000	Komuna dhe Qeveria	4 vit			
19	Udhërrëfyes për promovimin e bizneseve	10.000	Qeveria Lokale, Asociacioni lokal i bizneseve, Agjencioni për regjistrimin e të papunëve, OJQ-te dhe Asociacionet e të rinjëve	1 vit			
20	Ndërtimi i pikave informuese në Prishtinë	80.000	Asociacioni lokal i bizneseve, Qeveria Lokale, OJQ-te dhe Asociacionet tjera, Inst. Publike	3 vit			
21	Projekti Diaspora , nxitja e investitoreve nga Diaspora (ditët e diasporës)	45.000	Komuna, OJQ-të dhe agjencionet promovuese	4 vite			
22	Promovimi i bashkepunimit ekonomik me qytetet tjera nga vende te ndryshme	40.000	Asociacioni lokal i bizneseve, Komuniteti i biynesit - Sektori Privat, Komuna, OJQ-te dhe Asociacionet tjera, Inst.Publike	4 vite			

23	Zyra qendra për Promovimin e Investimeve dhe Turizmit në Prishtinë	8.000	Komuna, donatorët, shoqëria civile	1 vit		
24	Trajtimi i staffit komunal për menaxhim efikas të projekteve dhe menaxhimin e financave publike	100.000	Komuna dhe firmat konsulente	4 vite		
25	Këshillime të biznesit Vauçerët (100 biznese x 1000 E)	100.000	Komuna, OJQ-të dhe agjencionet promovuese	3 vite		
<b>Vlera e projekteve per Synimin e dytë</b>						
<b>Synimi 3. Avansimi i kapaciteteve institucionale dhe fizike për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve</b>						
26	Shpronësime	15.000.000	Komuna dhe bashkëfinancim me Qeverinë	4 vite		
27	Zona ekonomike në afërsi të Gazimestanit	1.500.000	Komuna	2 vite		
28	Promovimi i punesimit te te rinjve dhe bizneseve	500.000	Komuna, Asociacioni lokal i bizneseve, Agjencioni për regjistrimin e te papunëve, OJQ-te dhe Asociacionet e të rinjëve	4 vite		
29	Projekte me bashkefinancim dhe promovim	150.000	Komuna, donatorët, shoqëria civile	3 vite		
<b>Vlera e projekteve per Synimin e tretë</b>						
<b>17.150.000</b>						



	Synimi 5. Zhvillimi i qëndrueshëm urban, hapsinor dhe hapësinor					
37	Përfundimi i Planit zhvillimor komunal	90.000	Komuna	2013		
38	Përfundimi i Planit zhvillimor urban	80.000	Komuna	2013		
39	Përfundimi i Planit rregullues për Prishtinën e Re, Planit Rregullues Prishtina e Re- Qender, Planit Rregullues Prishtina e Re Perëndim	320.770	Komuna	2013		
40	Projekti I GIS	700.000	Komuna dhe donatorët	3 vite		
41	Vizitë studimore për marrjen e përvajave nga rajoni për ngritjen e kapaciteteve perkatese të stafit	100.000	Komuna	3 vite		
42	Hartimi i projekteve për rrugë, infrastrukturë nëntokësore, dhe projekte tjera ubraistike dhe kadastrale	2.800.000	Komuna	4 vite		
43	Plotesimi i Planit rregullues per Tophane	35.000,00	Komuna	1 vit		
44	Hartimi planit rregullues Qendra	150.000	Komuna	1 vit		
45	Hartimi i Planit rregullues në lagjen Kodra e Trimave 2	130.000	Komuna	1 vit		
46	Hartimi i Planit rregullues për Lagjen Vreshtat	80.000	Komuna	1 vit		
47	Hartimi i Planit rregullues për lagjen Velani – Dodona	50.000	Komuna	1 vit		

48	Hartimi i Planit rregullues për Bëmic - Bardhosh	120.000	Komuna	2 vite		
49	Hartimi i Planit rregullues për qytetin e vjetër	150.000	Komuna, MKRS (Dep.i mbrojtjes..)	1 vit		
50	Planit rregullues Kodra e Trimave 1	136.800	Komuna	1 vit		
51	Planit rregullues Mati 2	62.450	Komuna	1 vit		
52	Revidimi i planit rregullues Kalabria, Lakrishte, Arberia 3, Sofalia	177.489	Komuna	1 vit		
53	Ndërtimi i segmentit të Unazës së Mesme (Shkup- Autostrada e Durrësit)	9.000.000	Bashkëfinancim, Qeveria	2 vite		
54	Ndërtimi i pjesës së segmentit të Unazës së Mesme (udhëkryqi Gjilan Ferizaj deri te Pishina e Gërmisë)	10.000.000	Bashkëfinancim me Qeverinë	4 vite		
55	Ndërtimi i Unazës nga Rruga e Fushë Kosovës deri në rrugën për Podujevë.	15.000.000	Bashkëfinancim me Qeverinë	4 vite		
56	Investimet private në ndërtime (840.000 m2 banimi, 360.000 m2 afarizem dhe 200.000 m2 garazha në objekte banesore)	-	Sektori privat	2013-2016		1.200.000.000
57	Regjenerimi dhe ndërtimi i rrugës dhe trotuareve me infrastrukturë të përshatshme nga Xhamia e Qarshisë deri te Xhamia e madhe (zona historike)	1.200.000	Komuna	2014-2015		
58	Zgjerimi i rrugës nga "Fusha e Pajtitit"-Grashticë	1.800.000	Komuna/bashkëfinancim me Min.e Infrastr.	3 vite		

59	Vazhdimi i rrugës "B" faza e tretë dhe katërt	4.000.000	Komuna	2016		
60	Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku" faza e tretë dhe katërt	1.500.000	Komuna	2015-2016		
61	Ndërtimi i rrugës "A"	2.000.000	Komuna	2016		
62	Ndërtimi i rrugës "Shaqir Igrishta"	300.000	komuna	2014		
63	Vazhdimi i ndërtimit të Unazës Qendrore deri te rrethrotullimi	4.200.000	Komuna /bashkëfinancim me Qeverinë.	2015-2016		
64	Ndërtimi i nënkalimit nën sheshin Nënë Tereza që lidhë rrugën Shkodra me rrugën Rexhep Luci	500.000	Komuna	2014		
65	Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku" faza e dytë	1.199.661	komuna	2013-2014		
66	Ndërtimi i rrugës "Ndue Përleshi"	871.547	komuna	2013-2015		
67	Ndërtimi i rrugës "Isa Kastrati-Mat"	850.000	komuna	2013		
68	Rikonstruktimi i pllatosë së Kurizit në Lagjen Dardania	600.000	Komuna	2014		
69	Rrugica, tortuarë dhe parkingje në Lagjen Dardania	350.000,00	Komuna	2014		
70	Rrugë, tortuarë dhe parkingje në Lagjen Kalabria	350.000,00	Komuna	2014		
71	Rrugë, tortuarë dhe parkingje në Lagjen Mati 1	400.000,00	Komuna	2014		
72	Trotuarë dhe parkingje në Lagjen Ulpiana	300.000,00	Komuna	2014		

73	Rrjeti i kanalizimit në lagjet e reja të urbanizuara	650.000,00	Komuna	2014		
74	Lagja Dodona, rrugët: Afrim Vitija, Shaban Polluzha, Gustav Majer, Tringë Smajli, Svetozar Marković, Mustaf Kruja dhe Zeki Shylemaja	105.404,50	Komuna	2013		
75	Lagja Qendresa, Vetërnik, rrugë dhe rrugica	142.172,50	Komuna	2013		
76	zLagja Janina, rrugët: Krahu 4, 5, 6 dhe 7 djathtas	127.267,50	Komuna	2013		
77	Rindërtimi i rrugëve: „Marije Shllaku, Mentor Retkoceri, Kajtas Ramadani, Migjeni	48.227,00	Komuna	2013		
78	Tophane ndërtimi i rrugëve: Sokol Dobrosi, Pjetër Bogdani, Feriz Blakqorri, rruget lidhese Feriz Blakqori Lidhja e Prizrenit, rr. Lidhja e Prizrenit rruga e Vushtrrisë dhe kanalizimi	360.000	Komuna	2013		
79	Arbëri, rrugët: Murat Mehmeti, Mehmet Ali Vrioni, 7 Shtatori, Azem Jashanica, Ismail Qemajli, Selim Berisha, 24 Maji, Mir'hat Frashëri rrugica në të majtë të rr Xhafer Deva	465.000	Komuna	2013		



80	Kodra e Trimave, rrugët dhe kanalizimi: Ibrahim Fehmiu, kahu i majtë 1, i jamtë 2 i djathtë 3, rr lidhëse Afrim dhe Rifat Krasniqi, ana e majtë 1, ana e djathtë 3, dalja te hekurudha Mentor Retkoceri, kanalizimi në rr. Rifat Krasniqi, Ibrahim Kelmendi, faza e dytë, kanalizimi në rr. Ibrahim Kelmendi, rrjeti i ujësllësit në rr. Ibrahim Kelmendi, Niket Dardani vazhdim në dy krahët dhe kanalizimi.	193.471	Komuna	2013		
81	Mat, rrugë dhe kanalizime: lagja e gashëve krahu 1 dhe 2, rr të stacioni krahu 1,2,3,4, rrugicë në Zllatar krahu i djathtë, Malush Kosova, kroji te hoxha, Resmi Durmishi, kanalizimi te fusha e sportit, rruga te pompa, krahu 1,2,3,4,5, lagja e Krasniqëve, krahu i parë, rruga afër depos Përpërimi.	318.000	Komuna	2013		
82	Parkingu te Taukbashqe, te banesat e vjetra	51.823	Komuna	2013		
83	Parkingu te restorant Rugova	8.603	Komuna	2013		
84	Lagja dardanija: trotualet në rrugen „bill clinton“	46.242	Komuna	2014		
85	Rikonstruimi i rrugëve „Mustafë Venhari-Lekë Dukagjini-Ilaz Kodra	176.786	Komuna	2013		
86	Rrugicat në Lagjen Ulpiana	46.112	Komuna	2013		

87	Ndërtimi i rrugëve dhe trotuarve „Zija shemsiu“, imzot nikë prela, „mark dizdani“ dhe „ motrat qirjazi“	110.877	Komuna	2013-2014	
88	Segmenti i rruges afër Amasadës Zvicërane dhe parkingu afer Kolegjium Kantorium dhe rindërtimi i rrugës prapa QKUK-së	41.548	Komuna	2013	
89	Rrugë urbane dhe zgjerim i qytetit sipas planeve urbane	6.000.000	Komuna	2015-2016	
90	Ndërtimi i rrugës “Enver Maloku” faza e parë	1.187.768	komuna	2013-2014	
91	Ndërtimi i rrugës “Hasan Remniku”	388.516	komuna	2013	
92	Ndërtimi i rrugëve në Lagjen Dodona	110.000	Komuna	2014	
93	Ndërtimi i rrugës “Trepça”	558.195	komuna	2013-2014	
94	Sanimi i gropave në qytet	245.385	komuna	2013	
95	Ndërtimi i kanalizimit ne Leban	63.289	Komuna	2013-2014	
96	Ndërtimi i kanalizimit në Prugovc	40.868	Komuna	2013	
97	Rruga me zhavor „Slivovë-Gulmivad“, Asfaltimi i rrugës Grashiticë „Lagjësja Rrustemaj“	119.147	Komuna	2013	
98	Rikonstruimi i rrugës në Lebanë dhe ndërtimi i trotuarve në Bardhosh	158.937	Komuna	2013	
99	Rikonstruimi i rrugës Bardhosh, Bërbicë e Epërme dhe asfaltimi i rrugës Grashiticë „Lagjësja Hamzaj“	119.147	Komuna	2013	

100	Asfaltimi i rrugës „Prapashticë-lagj. Cubaj dhe në lagjen e Govoriëve	124.541	Komuna	2013		
101	Asfaltimi i rrugës në Grashiticë lagjja e Ajetëve	120.350	Komuna	2013		
102	Asfaltimi i rr. Te shkolla në Gillogovicë	98.716	Komuna	2013		
103	Rikonstruimi i rr. Lidhëse në Bardhosh dhe kanalizimit fekal	147.000	Komuna	2013		
104	Asaltimi i rrugës Keqekollë-Nishecë Segmenti i parë L=3km	257.922	Komuna	2013		
105	Rikonstruimi i rrugës-me zhavor në fshatin. Keqekollë lagjja Qelaj	67.400	Komuna	2013		
106	Ndërtimi i rrugëve dhe rrugicave në Mramor, Busi dhe Suteskë dhe lagje tjera rurale	526.852	Komuna	2013		
107	Rrugicat në lagjen „Ugrija“ në Grashiticë, dislokimi i shtyllave elektrike	46.936	Komuna	2014		
108	Rrugët rurale	3.000.000	Komuna	2015-2016		
109	Rruga krahu i djathtë lagjja „Hamzaj“ Makovc	3.523	Komuna	2013		
110	Ndërtimi i kanalizimeve dhe rregullimi i shtratit të lumit prej “Fushës së Pajtitit-Makovc”	300.000	Komuna /bashkëfinancim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor	2 vite		
111	Ndërtimi i kolektorit në fshatin Shkabaj	500.000	Komuna/bashkëfinancim me Min. e Ambientit	2 vite		

112	Ndërtimi i rrugës prej rr. "Vëllezrit Fazliu-Sinidoll-Bërnice e Eperme"	1.100.000	Komuna	2014-2015		
113	Ndërtimi i kolektorit në fshatin Hajvali	800.000	Komuna/bashkfinancim me Ministrinë e Ambientit	2015-2016		
114	Ndërtimi i rrugës Busi-Marevc faza e dytë	150.000	Komuna	2016		
115	Ndërtimi i rrugëve në lagjet "Balaj" dhe "Rexhaj" në Rimanishtë	200.000	Komuna	2013-2014		
116	Asfaltimi i rrugës Viti-Bullaj	280.000	Komuna	2013		
117	Ndërtimi i rrugës Llukar-Siqevë	300.000	Komuna	2015		
118	Ndërtimi i rrugës Siqevë-Sharban faza e dytë	600.000	Komuna	2016		
119	Ndërtimi i rrugës Vidime-Lumi i Marevcit në Marevc	650.000	Komuna	2016		
120	Ndërtimi i rrugës Sillovë-Kukkavicë	150.000	Komuna	2016		
121	Ndërtimi i rrugës në Hajvali (zgjerimi i rrugës së vjetër të fshatit)	300.000	Komuna	2015		
122	Ndërtimi i rrugës Rimanishtë-Siqevë pjesa e parë-faza e dytë	200.000	Komuna	2014		
123	Ndërtimi i rrugëve me zhavor në zonat rurale	300.000	Komuna	2013		
124	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Bardhosh	300.000	Komuna	2013		
125	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Bërnice e Ulët	200.000	Komuna	2013		

126	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Bërnice e Epërme, Sinidoll	250.000	Komuna	2013		
127	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Prugovc	150.000	Komuna	2013		
128	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Barilevë	150.000	Komuna	2013		
129	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Leban	100.000	Komuna	2013		
130	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Besi, Vranidoll	150.000	Komuna	2013		
131	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Rimanishtë	100.000	Komuna	2013		
132	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Prapashticë	150.000	Komuna	2013		
133	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Hajvali	250.000	Komuna	2013		
134	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Marevc	250.000	Komuna	2013-2014		
135	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Llukar, Siqevë, Makovc, Grashiticë, Sharban	350.000	Komuna	2013-2014		
136	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Keqekollë, Ballaban	120.000	Komuna	2013		
137	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Shkabaj	150.000	Komuna	2014		
138	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Shashkovc	150.000	Komuna	2013		
139	Ndërtimi i rrugëve sekondare në fshatin Kolliq	250.000	Komuna	2013-2014		

140	Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve me asfalt dhe me kubza në lagjet: Besiana, Kodra e Trimave, G allapi, Qamëria, Vneshta, Medrese, Arbëria, Tophane, Gjinaj, Normales, Sofali, Vellusha, Ilirida, Tauk Bashqe, Velani, Dodona, Qendra, Muhagjerëve, Kodra e Diellit, Dardania, Ulpiana, Kalabria dhe Mati.	1.500.000	Komuna	2013-2014	1.200.000.000
<b>Vlera e projekteve per synimin e pestë</b>		<b>86.279.740</b>			
<b>Synimi 6. Përmirësimi i shërbimeve publike në përputhje me tiparet e një qyteti europian</b>					
141	Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi	500.000	Komuna	4 vite	
142	Mirëmbajtja dim. e rrugë. trot. debllokomi i kanal. Atmosferik dhe pesetave (heqja e bores, fshirja e mbeturinave dhe sipas kushteve atmosferike larja e tyre).	2.400.000	Komuna	4 vite	
143	Pastrimi (fshirja, larja ditore) i rrugë. trot. Në sezonin veror. Pastrimi i kanal. Atmosferik dhe pusetave	2.000.000	Komuna	4 vite	
144	Mirëmbajtja verore dhe dimerore e rrugëve rurale	1.400.000	Komuna	4 vite	

145	Mirëmbajtja e monumenteve, fontanave dhe krojeve publike	200.000	Komuna	4 vite	
146	Mirëmbajtja e varrezave	200.000	Komuna	4 vite	
147	Krijimi i kadastrës të varrezave të qytetit	200.000	Komuna	4 vite	
148	Krijimi i kadastrës së sinjalizimit vertikal të semaforëve	120.000	Komuna	2 vite	
149	Digjitalizimi i sistemit të ndriqimit	200.000	Komuna	2015-2016	
150	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriqimit publik (në parqe, hapësira të institucioneve komunale, montimi i trupave ndriçues LED, ndërtimi i shtyllave dhe montimi i ormanëve, qendra e monitorimit)	1.200.000	Komuna	4 vite	
151	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve	800.000	Komuna	4 vite	
152	Rregullimi i vendeve të kontejnerëve dhe furnizimi me kontejner mbitokësor, nentokësor dhe shporta	600.000	Komuna	4 vite	
153	Furnizimi me makineri dhe pajisje	600.000	Komuna	4 vite	
154	Rregullimi i vend ndaljeve të autobusëve dhe rregullimi i infrastruktures për transport	200.000	Komuna	4 vite	
155	Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe parqeve të qytetit	600.000	Komuna	4 vite	

156	Trajtimi i kafshëve endacake	200.000	Komuna	4 vite		
157	Shpimi i puseve	200.000	Komuna	4 vite		
158	Ndërtimi i Tregut në Zonën Ekonomike	500.000	Komuna/PPP	2014-2015		
159	Rregullimi i parkut të "Gërmisë"	350.000	Komuna	2013-2014		
160	Rregullimi i parkut në "Taubashqë"	450.000	Komuna	2013		
161	Pastrimi i mbetjeve ndërtimore gjatë tërë vitit	200.000	Komuna	4 vite		
162	Pastrimi i shtratit të lumenjve – pirockave portave të lumunjëve	200.000	Komuna	4 vite		
163	Blerja e kamionëve dhe kontenjerëve për mbeturina	450.000	Komuna	4 vite		
164	Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe parqeve të qytetit	4.200.000	Komuna	4 vite		
165	Ndërtimi i deponisë për mbetjet ndërtimore	500.000	Komuna/Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	4 vite		500.000,00
166	Hartimi i projektit për elektrifikim të transportit - tramvaj dhe trolejbus	50.000	Komuna	2014		
167	Elektrifikimi i transportit - Pjesa I	1.000.000	Komuna	2015-2016		
168	Renovimi i Strehimoreve	100.000	Komuna	3 vite		
169	Formimi i njësisë vullnetare të zjarrrfiksëve	150.000	Komuna	3 vite		
<b>Vlera e projekteve për synimin e gjashtë</b>		<b>19.770.000</b>				<b>500.000,00</b>





179	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHF 7 Marsi në L Kalabria	150.000	Komuna	2013		
180	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHF Pavarasia në L e Spitalit	150.000	Komuna	2013		
181	Ndërtimi i SHF në lagjen Kalabria	800.000	Komuna	2014-2015		
182	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në lagjen e Veterinikut	1.000.000	Komuna	2015-2016		
183	Ndërtimi i SHF në lagjen Përroi i Njelmët	800.000	Komuna	2015-2016		
184	Funksionalizimi i qendrave për ngritje profesionale	300.000	Komuna/Donatorët	3 vite		
185	Rikonstruimi i objektit të vjetër të gjimnazit E Qabëj dhe ridestnimi për objekt të Shkollës Fillore në Sofali	250.000	Komuna	2013-2014		
186	Rregullimi i oborrave dhe ndërtimi i rrethojave të shkollave	950.000	Komuna	2013-2016		
187	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHF Ganimete Terbeshi/ Llukar	150.000	Komuna	2013		
188	Rikonstruimet dhe gëlqerosja e shkollave	1.850.000	Komuna	Deri 2016		
189	Ndërtimi i objektit të sallës së edukatës fizike në SHF Barrilevë	150.000	Komuna	2016		
190	Rekonstruimi i objektit të shkollës fillore Elena Gjika faza e parë	300.000	Komuna	2014		
191	Ndërtimi i fushave sportive në disa shkolla	150.000	Komuna	3 vite		

192	Instalimet e reja dhe renovimet e ngrohjes qendrore	400.000	Komuna	2016		
193	Ndërtimi i qerðeve për fëmijë	1.200.000	Komuna	2015-2018		
194	Investime në salla të edukatës fizike	800.000	Komuna	2015-2016		
195	Paisjet me kabinete, inventar shkollor dhe me libra për biblioteka shkollore	1.200.000	Qeveria Lokale	4 vite		
<b>Vlera e projekteve për synimin e shtatë</b>		<b>17.806.000</b>				
<b>Synimi 8. Ndërkombëtarizimi, rritja e cilësisë dhe numit të ngjarjeve kulturore dhe sportive me infrastrukturë adekuatë institucionale, teknike dhe profesionale</b>						
196	Salla Universale kulturore dhe galeria e qytetit	2.000.000	Komuna	2014-2016		
197	Teatri i Qytetit Dodona	400.000	Komuna	2015-2016		
198	Muzeu i Ekzodit	300.000	Komuna	2015-2016		
199	Murale për zbukurimin e qytetit	150.000	Komuna	2014-2016		
200	Pajisja e bibliotekave me libra	300.000	Komuna	4 vite		
201	Renovimi i pishinës së Gërmisë	465.614	Komuna	2013-2014		

202	Ndërtimi i pishinës së mbyllur në Gërmii (afër bazenit të Gërmisë)	1.000.000	Komuna	2013-2015		
203	Qendra sportive rekreative në zonat rurale		PPP	2013-2015	3.500.000	
204	Skate PARK	195.000	Komuna	2015-2016		
205	Restaurimi i Xhamisë së Qarshisë (Jashar Pasha)	120.000	Komuna	2013		
206	Hamami i madh - punët përfundimtare	450.000	Komuna	2013		
207	Ndërtimi i fushave sportive dhe këndeve për fëmijë në zonat rurale	600.000	Komuna	2014-2016		
208	Ndërtimi i terrenit sportiv për basketboll në lagjen „Kodra e Diellit,	30.000	Komuna	2014		
209	Ndërtimi i terrenit për basketboll në fshatin Bardhosh	30.000	Komuna	2013		
210	Ndërtimi i terrenit për basketboll në fshatin Hajvali	30.000	Komuna	2013		
211	Ndërtimi i terrenit për basketboll në lagjen Vreshta - Prishtinë	30.000	Komuna	2013		
212	Renovimi i dy terreneve sportive në lagjen Kodra e Diellit Prishtinë	8.000	Komuna	2013		
213	Ndërtimi i 4 (katër) fushave të tenisit në Tauk Bashqe	146.392	Komuna	2013		

214	Ndërtimi i terreneve sportive	550.000	Komuna	2015-2016	
215	Vendojsa e kulmit dhe montimi i ulëseve në Stadiumin e Qytetit	200.000	Komuna	2013	
<b>Vlera e projekteve per synimin e tete</b>		<b>7.005.006</b>			<b>3.500.000</b>
<b>Synimi 9. Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale</b>					
216	Ndërtimi i Spitalit të qytetit	8.000.000	Komuna, Qeveria Qëndrore dhe donatorët	2014-2016	
217	Ndërtimi i një objekti banesor për 50 familje të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së.	850.000	Komuna	2013-2014	
218	Ndërtimi i një objekti banesorë për 50 familje në asistencë sociale	1.000.000	Komuna	2013-2014	
219	Ndërtimi i QMF nr.4 - në lagjen e Muhaxherëve	500.000	Komuna	2013-2014	
220	Ndërtimi i Ambulancës në fshatin Keqekollë	110.000	Komuna	2013	

221	Pajjise mjekësore	500.000	Komuna	2013-2016		
222	Furnizimi me autoambulanca shëndetësore	600.000	Komuna	2013-2016		
223	Furnizimi i QMF-ve të reja dhe atyre ekzistuese me inventar,	200.000	Komuna	2013-2016		
224	Renovime, përmirësimi i infrastrukturës së objekteve shëndetësore dhe sociale	300.000	Komuna	2013-2016		
225	Ndërtimi i QMF nr. 1 - në rrugën Ilir Konushevc	400.000	Komuna	2015		
226	Instalimi dhe funksionalizimi i Sistemit të Informitit Shëndetësor (SISH)	250.000	Komuna,, Ministria e Shëndetësisë dhe organizatat donatore	2014-2016		
227	Ndërtimi i Qendrës për qëndrim ditë të personave me aftësi të kufizuar	200.000	PPP	2014-2015		
228	Dezinsektimi hapsinor i Prishtinës	600.000	Komuna	2013-2016		
229	Deratizimi vjeshtor i podrumëve dhe garazhave	240.000	Komuna	2013-2016		
230	Deratizimi i rrjetit të kanalizimit	200.000	Komuna	2013-2016		
<b>Vlera e projekteve per synimin e nëntë</b>		<b>13.950.000</b>				
<b>Gjithsej vlera e projekteve të parapara me strategji</b>		<b>66.503.246</b>			<b>42.700.000</b>	<b>1.200.500.000</b>

## 14. SHTOJCA I: EKIPI I HARTIMIT TË STRATEGJISË

### I. Grupi për Ekonomi dhe Zhvillim Rural

Jakup Ademi, kryesues  
 Sadije Krasniqi  
 Naim Berisha  
 Merita Tolaj  
 Hamdi Dervishi  
 Islam Hamiti

### II. Grupi për Financa , Buxhet dhe Administratë

Hyra Muharremi, kryesuese  
 Artan Osmani  
 Teuta Rugova

### IV. Grupi për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Sevdije Abazi, kryesuese  
 Lindita Hajdari  
 Valbona Gashi

### V. Grupi për Shëndetësi dhe politika sociale

Gani Demolli, kryesues  
 Igballe Përçuku

### V. Grupi për Planifikim Hapësinor, Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Infrastrukturë Lokale

Nazmie Tora, kryesuese  
 Ferit Fazliu  
 Lindita Beqiri  
 Habib Qorri  
 Qazim Bajrami

## **Ekspertët e angazhuar nga Instituti për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël-IESB dhe D&D Business Support Center**

**Prof. Dr. Besnik A. Krasniqi**, udhëheqës i projektit

**MSc. Saranda Lajqi**, koordinatorë e projektit

**Dr. Skënder Kaçiu**, fasilitator, grupi Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

**Dr. Florin Peci dhe Safet Fazliu**, fasilitatorë, grupi Ekonomi dhe Financa

**MSc. Sokol Krasniqi**, fasilitator, grupi Arsimit, Kultura, Rinia dhe Sporti

**Albana Gashi**, fasilitatore, grupi Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

**MSc. Fisnik Bajrami**, fasilitator, grupi Shëndetësia dhe Politika Sociale

**Ing. Naim Hoxha dhe MSc. Saxhide Mustafa**, fasilitator, grupi Planifikim dhe Urbanizëm

**MSc. Bardha Qirezi**, ligjëruese

**MSc. Alban Zogaj**, ligjërues

### **Konsulent vendor:**

**Sejdi Osmani**, ekspert për zhvillim lokal





